



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 14 nëntor 2014, në mbledhjen e XI-të (njëmbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm, drejtorët e Drejtorive komunale, z. Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, i njoftoj këshilltarët e Kuvendit për trajnimin e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës përkrahur nga HELVETAS Swiss Intercooperation – Programi DEMOS që do të mbahet me anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës më datën 20 dhe 21 të këtij muaji në fshatin Orllan – restaurant Adriatiku, dhe shtoi, për më gjerësisht mund të informoheni në e-mail-in të cilin ju kam dërguar ftesën të gjithëve.

Gjithashtu ju njoftoj se ne planifikojmë të mbajmë edhe një mbledhje në muajin dhjetor me dy pika të rendit të ditës, përkatësisht emërtimin e rrugëve dhe planin vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2015, përveç nëse paraqitet edhe ndonjë tjetër pikë, kështu që materialin për këtë mbledhje e besoj se e keni pranuar me kohë, po ashtu ju njoftoj se një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar mjaft gjerë për këto pika dhe i kemi rekomanduar Kuvendit ashtu siç i keni para vetës në konstatime.

z. Bahri Selimi, theksoi, në mbledhjen e nëntë të rregullt të Kuvendit është miratuar Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015 për të cilën konsiderojmë se është miratuar pa i përmbushur dy procedura paraprake: 1- Rregullorja e cekur është miratuar pa qenë e përfshirë fare në rend dite, andaj pyesim se si ka mundësi një rregullore e një rëndësie të veçantë të miratohet pa qenë fare në rend të ditës, apo ndoshta mund të ndodh që nuk ka rëndësi fare kjo Rregullore e cila duke u bazuar në raportin e fundit financiar konsiderohet që sjell më së shumti të hyra vetanake për Komunën e Podujevës. 2- për Rregulloren në fjalë nuk është hapur fare debat nga Kryesuesi i Kuvendit, andaj edhe për këtë pyesim se si ka mundësi që të miratohet një rregullore aq profitabile për Komunën e Podujevës pa u debatuar fare për atë. I nderuari Kryesues i Kuvendit, ju që e morët këtë vendim në mënyrë arbitrare, a ju ka shkuar në

mendje se këshilltarët e Kuvendit, për Rregulloren në fjalë eventualisht mund të kenë ndonjë vërejtje, qoftë pozitive qoftë negative. Ne Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje mendojmë se me rastin e miratimit të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015 është ngulfatur demokracia parlamentare dhe është censuruar fjala e lirë e këshilltarëve të Kuvendit, prandaj kërkojmë që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të përfshihet edhe një pikë shtesë, përkatësisht, rishqyrtim, debat dhe miratim i rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015.

z. Adelinë Stublla, theksoi, si pikë e rendit të ditës për këtë mbledhje kërkojmë të jetë pika të cilën si çështje ne Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje e kemi ngritur shtatë muaj më parë, përkatësisht; çështja e stimulimit të lehonave, çështje e cila në Komunën tonë si duket ka rënë në vesh të shurdhër, andaj kërkojmë që kjo çështje të përfshihet në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me propozimin e bërë nga këshilltari z. Bahri Selimi, sigurisht jeni në dijeni se me rastin e miratimit të projektbuxhetit të Komunës për vitin 2015, si nën pikë ka qenë edhe propozimi i Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015, gjë për të cilën mund të them se ka qenë edhe rekomandim i Komitetit për Politikë dhe Financa që rregullorja në fjalë të miratohet njëkohësisht me projektbuxhetin e Komunës, Rregullore e cila nuk ka pësuar kurrfarë ndryshimi nga ajo e mëparshme, kështu që ato dy pika janë votuar dhe miratuar bashkërisht dhe nuk e shoh të arsyeshme të kthehemi prapa të shqyrtojmë ato dy pika ngase nuk kemi nevojë ta bëjmë një gjë të tillë sepse në këtë mënyrë kanë vepruar edhe Komunitet tjerë, pra edhe Komuna jonë nuk ka pasur nevojë të bëjë ndryshime në atë Rregullore, por meqë ishte propozim unë e hedh në votim, propozimin e cekur që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të përfshihet edhe pika e propozuar nga këshilltari z. Bahri Selimi.

Pas votimit u konstatua se me 16 votë për, 14 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozimi i z. Bahri Selimit që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të përfshihet edhe pika:

- **Rishqyrtim, debat dhe miratim i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015**
-

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me propozimin e bërë nga këshilltarja e Kuvendit z. Adelinë Stublla, konsideroj se për këtë çështje ne sot nuk mund të marrim vendim ngase buxheti i Komunës për vitin 2015 është miratuar dhe nuk është paraparë vijë buxhetore për këtë çështje, mirëpo ne si Kuvend mund t'i rekomandojmë Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që ta shqyrtojë këtë për hera tjerë.

z. Haki Rudari, theksoi, konsideroj se ne si Kuvend është mirë të marrim një vendim rreth propozimit të z. Adelinë Stublla, ngase është kërkesë shumë legjitime ku mund të marrim ndihmë të gjitha gratë lehonat të Komunës së Podujevës, dhe si shembull mund të marrim Komunën e Hanit të Elezit, kështu që neve si Kuvend nuk na pengon që të marrim një vendim unanim.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, besoj se ne të gjithë e kemi një qëllim që aty ku mundemi të bëjmë mirë, mirëpo propozimi i cekur ka implikime financiare dhe se buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2015 është miratuar para dy muajve, dhe një propozim i cekur konkret duhet të bëhet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, andaj konsideroj se ne sot mund të debatojmë por pa kurrfarë përfundimi, pra le të jetë rekomandim për Drejtorinë përkatëse që në një prej mbledhje të ardhshme të përgatitin propozim konkret.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, nuk kam asgjë kundër ndonjë vendimi të cilin e voton Kuvendi, mirëpo përfshirja në rend dite e propozimit përkatës i cili ka të bëjë me Rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2015, e cila në fakt u votua, mirëpo ta keni të qartë se keni votuar, pa ndonjë arsye të shëndosh, kundër një Rregulloreje e cila është miratuar në një mbledhje të mëhershme, sepse vendimi i miratuar në këtë Kuvend për miratimin e projektbuxhetit përfshin edhe rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2015, prandaj nuk e shoh të arsyeshme që në këtë mbledhje të votohet kundër një rregulloreje që është miratuar po në këtë Kuvend rreth dy muaj më parë, ngase nuk shoh arsye që mund të kthehet një vendim i tillë mbrapa, ndoshta është shumë lehtë të votohet për ose kundër, mirëpo duhet të analizohet një çështje e tillë ngase Rregullorja përkatëse ka qenë në pako me projektbuxhetin e Komunës, apo ndryshe rregullorja në fjalë ka qenë nën pikë dhe askush nuk është lajmëruar për të diskutuar për atë, prandaj unë konsideroj se nuk është diçka e mirë por megjithatë është vendim i juaji. Sa i përket propozimit të dytë të z. Adelinë Stublla, në lidhje me stimulimin e grave lehona, po ashtu me rastin e miratimit të projektbuxhetit të Komunës është dashur të insistoni që ky Kuvend të ndan mjete për atë çështje, por jo tani kur ka rreth dy muaj që është marrë vendim për miratimin e projektbuxhetit sepse një vendim i tillë do të ishte kundërshtim me vendimin e projektbuxhetit, ngase çdo vendim që miratohet duhet të ketë mbështetje financiare për tu zbatuar ndërsa ne nuk mund ta dimë se sa mund të kemi mbulesë financiare nëse miratohet një vendim që të stimulohen të gjitha gratë lehona të cilat jetojnë në Komunën e Podujevës. Prandaj kjo çështje mund të diskutohet dhe mund të gjendet ndonjë variant në rastet e propozimit për miratimin e projektbuxhetit apo në rastin e rishikimit të buxhetit sepse tani nuk mund të gjejmë mjete financiare për zbatim të një vendimi të tillë. Pra nuk them se jemi kundër këtij propozimi por ne kemi miratuar një buxhet ndërsa tani edhe nëse e miratojmë këtë propozim me siguri se do të hasim vështirësi në zbatim.

z. Haki Rudari, theksoi, lidhur me atë që kërkoj drejtori parafolës, unë them se z. Adelinë Stublla, ka rreth shtatë muaj që ka bërë këtë propozim dhe që ka qenë një kërkesë legjitime e bërë në këtë Kuvend, kështu që ajo çka e tha drejtori i bie se Ekzekutivi i Komunës nuk i merr parasysht kërkesat e këshilltarëve, ndërsa sa i përket Rregullores së tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2015, nuk ka qenë pikë e veçantë por ka qenë në pako me propozimin e projektbuxhetit të Komunës për vitin 2015, propozim të cilin ne e kemi kundërshtuar. Pra këto dy propozime nuk kanë të bëjnë aspak me çështje politike por ka të bëjë me interesat e qytetarëve në përgjithësi dhe nuk di pse ka hezitime dhe nuk përkrahen këto dy propozime, apo fundja, është përgjegjësi e Ekzekutivit të Komunës që propozimet e këshilltarëve kushdo që janë ata t'i merr parasysht dhe t'i shqyrtoj.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, për propozimin e parë nuk dua të flasë ngase ajo veç kaloi me vota dhe hyri si pikë shtesë për këtë rend dite, kurse lidhur me pikën e dytë të propozuar, sigurisht ne jemi dëshmitarë që këshilltarja nga radhët e LVV-së para 6-7

muajve ka bërë një kërkesë të tillë. Unë desha të kyçem rreth asaj që drejtori parafolës e tha se duhet të kemi mjete buxhetore për të zbatuar një vendim të tillë, gjë e cila është shumë e qartë, mirëpo jemi dëshmitarë që me rastin e ri-alokimit të mjeteve buxhetore për vitin 2014, nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - sektori i shëndetësisë janë marrë 10,000.00 €, dhe janë bartur në projektin për ndërtimin e shtëpive sociale për të cilin mendoj se i ka kaluar parametrat ligjor të prokurimit me arsyetim se oferta më e vogël ka qenë 110,000.00 €, e them këtë ngase në momentin që kalohen limitet e shumës së paraparë tenderi duhet të përsëritet, pra këtë çështje e kam ngritur edhe në KPF dhe në Kuvend. Prandaj i nderuari Kryesues i Kuvendit nëse Komunitet tjerë më të vogla dhe me kapacitete më të vogla buxhetore se Komuna jonë i stimulojnë gratë lehona në territoret e tyre, besoj se edhe ne kemi kapacitete dhe duhet të mbështetim propozimin e z. Adelinë Stublla.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, propozimi i parë kaloj me vota dhe hyri në rend dite për këtë mbledhje dhe sigurisht se ne do të debatojmë, mirëpo sa i përket propozimit të dytë ne shumica u pajtuam që në një mbledhje të ardhshme Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të përgatit një propozim të tillë dhe ta paraqet para Kuvendit, e them këtë ngase sot nuk kemi për çfarë të debatojmë ngase nuk kemi material, dhe se vetëm Ekzekutivi i Komunës është ai i cili i propozon Kuvendit propozime konkrete të tilla.

z. Avni Ajeti, theksoi, nuk jam në dijeni përse paraqiten hezitime për të debatuar për Rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2015, duke pasur parasysh faktin se konkretisht bëhet fjalë për familjet e Dëshmorëve, invalidët e luftës dhe kategori tjerë për të cilat konsideroj se nuk është e nevojshme t'i bihet rreth e qark çështjes së benefiteve për ato kategori, por mendoj se duhet të stimulohen nga ana e Komunës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, meqë nuk pati më këshilltarë të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedhi në votim rendin e propozuar të ditës me plotësim duke e përfshirë edhe pikën shtesë të propozuar nga z. Bahri Selimi, propozim i cili paraprakisht u miratua.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë.

2. Shqyrtimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Kuvendit më 29 shtator 2014 dhe 17 tetor 2014

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit të Komunës më 29 shtator 2014,

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës më 17 tetor 2014.

3. Raporti financiar për periudhën janar – shtator 2014

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështesim raportin financiar për periudhën janar – shtator 2014, dhe konsiderojmë se është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi dhe pasqyron të gjitha shpenzimet e Komunës së Podujevës, andaj si të tillë ne e përkrahim.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, ne një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar mjaft gjatë dhe unë me keqardhje e them se këtë vit e kam quajtur vit të kanalizimeve sepse 80% e të hyrave në këtë nëntëmujorë janë shpenzuar për kanalizime, ndërsa lidhur me pagesat e kryera nuk kemi çfarë të bisedojmë sepse për punët që janë kryer pagesat duhet të bëhen, mirëpo se a janë kryer punët mirë apo keq është çështje të cilën duhet ta debatojmë.

Lidhur me pagesat gjyqësore për vitin 2014 mendoj se për Komunën e Podujevës janë shuma të mëdha, gjë të cilën ne edhe më parë e kemi potencuar se do të ketë gjoba gjyqësore të cilat Komuna do të jetë e detyruar t'i paguan për shkak të lëshimeve të bëra. Lidhur me punët e kryera mendoj se janë bërë në mënyrën më të keqe ngase po ta marrim vetëm një si shembull e që është rruga “Emin Duraku” e cila është kryer në vitin 2013 me një cilësi shumë të dobët, por më shumë kemi qenë të interesuar rreth pranimit teknik të asaj rruge dhe garancia teknike e Komunës për përllogaritjet dhe për matjet e asaj rruge, ngase tani pas një viti kemi riparim të asaj rruge nga kompania përkatëse.

Sa i përket të hyrave vetanake, sipas këtij raporti problem kryesor paraqitet sepse të hyrat janë në nivelin më të ultë, realisht pajtohem me drejtorin parafolës i cili e tha se kemi pasur një rritje prej 17% nga vitet e kaluara, mirëpo shqetësuese paraqitet inkasimi i mjeteve buxhetore nga borxhlinjtë e mëdhenj, si dhe shqetësuese është lëshimi me qira i objektit të marrur me qira, shembull, “Mileniumi 2000” i cili qe 15 vite është i dhënë me qira dhe ka borxh rreth 50,000.00 € ndaj Komunës ndërsa tani i është lëshuar me qira prapë një pronari tjetër, në mbledhjen e KPF-së drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e tha se të gjithë borxhlinjtë e mëdhenj i kemi dërguar në proces gjyqësorë, ndërsa unë në cilësinë e juristit ju them se çdo faturë apo borxh mund të parashkruhet, dhe konsideroj se Komuna nuk do të mund të inkasoj ato mjete, shembulli tjetër i cili Komunës i ka paraqitur problem është edhe dhënia me qira e objektit në qytet, ish banka e biznesit, pas një muaji që është dhënë ai objekt me qira, pa dijeninë e drejtorëve të Drejtorive është hequr shtylla qendrore e atij objekti, dhe është dashur që të gjitha ato familje të evakuhohen për shkak të rrezikut që është paraqitur, ku pastaj është meremetuar disi por ata qytetarë kanë kërkuar të kenë garanci nga studentët e fakultetit teknik ose përndryshe ata qytetarë nuk do të jetojnë në atë banesë dhe i është dashur drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit që të bënë shpenzime duke kërkuar nga fakultetit teknik të bëjë studim të asaj gjendjeje, prandaj nuk jam në dijeni se si mundet që në një objekt të dhënë me qira ende pa marr vendimi formën e prerë të bëhen intervenime pa pasur leje nga inspektorët e Komunës, dhe pyes drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit se cili inspektor i Komunës ka qenë mbikëqyrës i punimeve dhe ndryshimeve që janë bërë në atë objekt, pse ka ndodh ajo dhe si do të rregullohet ai problem. Gjithashtu kemi rreth 300,000.00 € gjoba gjyqësore dhe nuk jemi në dijeni se si kanë rrjedhur proceset që kjo shumë është aq e lartë, andaj mendoj se drejtori përkatës i ka dërguar borxhlinjtë në procese gjyqësore por në anën tjetër i ka humbur proceset dhe ka ardhur deri te kjo shumë. Pra kjo vie si pasoj që kemi prona të dhëna me qira një pronari dhe ai pronar nuk paguan borxhin ndaj Komunës qe 15 vite kurse e lëshon pronën me qira palës së tretë duke përfutur vetë ai sepse nuk i paguan borxhin Komunës

dhe merr qira nga personi tjetër. Po ashtu e njëjta situatë qëndron edhe për objektin “beni dona” ku prapë ka filluar procedura për t’iu dhënë me qira të njëjtit person. Dua të them se ky raport financiar paraqet një gjendje reale, mirëpo i ceka vetëm 5 - 6 çështje konkrete prej të cilave ka ardhur kjo gjendje financiare të cilën e kemi.

Në një mbledhje të kaluar kam thënë se i kam fotografit të cilat janë bërë gjatë punimeve të kanalizimit në fshatin Llapashticë në fazën e ndërtimit ku janë paguar mbi 200,000.00 € (tregon fotot), shihet qartë cilësia e punëve, nuk është bërë shtresa me zhavorr dhe shihet një punëtor mbi gypa duke u munduar t’i fus në dhe, gjithashtu kemi situacionin e dokumentacionit të ndërtimit të kanalizimit në fshatrat Dumnicë – Llaushë në të cilin përshkruhen pusetat 38 - 50 metra kurse janë 100 – 102 metra gjë për të cilën drejtori i Drejtorisë përkatëse në mbledhjen e KPF-së e tha se kemi pasur disa pengesa me banorët për ata edhe është dashur të ndryshohen këto pika.

Kështu që kemi disa raste, si në infrastrukturë, si në të hyrat vetanake si në keqpërdorim të parasë publike, për të cilat mendoj se janë elemente për të cilat duhet të debatohet po të ishte vetëm njëra nga këto, mirëpo meqë tani në këtë raport na paraqiten më shumë raste konsideroj se është çështje e pushtetit lokal të merret me këto probleme.

z. Haki Rudari, theksoi, po bëhen afër një vit nga zgjedhjet e fundit lokale që kur u zgjodh Ekzekutivi i Komunës së Podujevës, ndonëse kishte shumë premtime për një qeverisje të përgjegjshme, funksionale dhe menaxhuese, por kjo nuk është duke ndodh.

Pra në vend të rezultateve konkrete qytetarët e Podujevës janë duke parë një zgjidhje kozmetike apo të paqëndrueshme. Fatkeqësisht në të gjitha fushat si: arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, ambient, infrastrukturë, kulturë, sport kemi ende ankesa të shumta nga qytetarët me të cilët ne vazhdimisht jemi në bashkëbisedim, jam i vetëdijshëm se ka investime në infrastrukturë dhe kanalizime, por prapë kemi ankesa të shumta të qytetarëve. Vlen të theksohet se ende kemi qeverisje me ushtrues detyre siç është rasti i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Lidhur me raportin financiar për periudhën janar – shtator 2014, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje e ka analizuar në detaje dhe ajo që bie në sy dhe që është një dallim i madh në mes të harxhimeve në paga dhe mëditje, gjë e cila është plotësisht e arsyeshme, dhe në investime kapitale me një përqindje prej 35.01%, gjë e cila për ne është mjaft shqetësuese, çështje për të cilën kemi debatuar edhe në KPF, mirëpo meqë tani jemi në Kuvend do të lëshohem dhe t’i cekë më në detaje. Mendojmë se problem në vete paraqitet edhe sigurimi i mjeteve por jo edhe investimet apo shpenzimet ku ato janë, ngase nevojat e qytetarëve janë të mëdha e lëre më kur ka buxhet dhe nuk investohet, e kjo është shqetësuese. E përshëndesim zvogëlimin e shpenzimeve në disa kode, megjithatë kemi dirsë rritje të shpenzimeve deri në 156% e deri në 705%, në vazhdim do t’i përmendi disa rritje në kode të ndryshme:

Shërbime kontraktuese tjera, ku nuk specifikohet çka por vetëm figuron shuma 195,176.58 € me rritje prej 8.38%. Furnizime për zyre në shumë 77,796.05 €, ku po ashtu nuk specifikohet se për çka është shpenzuar. Vaj, shuma 1,612.50 € me një rritje prej 41%. Dru, shuma 92,559.95 € një rritje prej 44.14%. Po ashtu një rritje të madhe të shpenzimeve kemi për derivate për gjenerator, shuma 3,268.74 € me një rritje prej 156.41%. Çështja të cilën ne si Grup e kemi analizuar mjaft mirë dhe për të cilën mendojmë se është mjaft shqetësuese, është mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste, shuma 2,603.20 € me një rritje prej 705.94% nga viti 2013 sa ishte 323,00 €. Çështja e cila neve na bërë përshtypje dhe të cilën pa tjetër duhet ta ngris është sigurimi i

automjeteve, ndonëse kemi një zvogëlim prej 58% të shpenzimeve në këtë vit, megjithatë derisa në vitin 2013 ishte shume prej 10,559.08 €, në vitin 2014 kemi një shumë 4,372.29 €, shtrojmë pyetje, a është zvogëluar numri i automjeteve zyrtare të Komunës, ose a është shitur ndonjë automjet, apo pse është ky zvogëlim aq i madh në krahasim me një vit më parë. Çështje tjetër të cilën ne sot duhet ta ngrisim është, të hyrat vetanake, ndonëse kemi dy kode që ka rritje të inkasimit të të hyrave përkatësisht në tatimin në pronë kemi rritje prej 85%, dhe taksa komunale 81%, gjë të cilën e përshëndesim, por nuk mund të themi se jemi komod sa i përket kësaj çështje ngase jemi në dijeni se në këto kode kemi edhe kushtëzim të marrjes së dokumenteve. Ajo që për ne paraqet shqetësim është të hyrat nga qiraja apo shfrytëzimi i pronës komunale ku këtu kemi një përqindje prej 56% gjë e cila është për çdo kritikë, pra do të thotë se Ekzekutivi i Komunës nuk mund të inkasoj mjete nga pasuria e vet gjegjësisht nga pasuria komunale. Ndonëse kemi raportin financiar janar – shtator 2014, kemi vërejtur dy pagesa për këtë vit për të cilat kërkoj sqarim nga Drejtoria përkatëse, 1- zgjerimi i shkollës fillore në fshatin Shajkoc shuma 14,727.83 €, dhe 2 - ndërtimi i objektit të ri shkollor në fshatin Siboc në shumë 19,114.14 €, kërkoja sqarim ngase pagesat figurojnë në këtë vit mirëpo sa unë jam në dijeni në këtë vit nuk është bërë kurrfarë investimi.

Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së do të vazhdoj të ndjek me vëmendje të gjitha zhvillimet në Komunën e Podujevës, do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët dhe do ta ngrisim zërin kudo që paraqitet nevoja pa dallime politike.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, e përgëzoj Ekzekutivin e Komunës sepse është viti i parë që fillon të paraqes raporte periodike që do të thotë se ka filluar një praktikë e re e mirë, mirëpo në anën tjetër praktikat janë të vonuara paksa ngase vijnë një muaj më vonë, sepse raportet duhet të bëhen tremujore, por megjithatë shpresoj se këto gjëra do të evitohen me kohë.

Rreth përmbajtjes së raportit dua t'i them dy - tri gjëra, lidhur me atë që ne ua kemi tërhequr vërejtjen është se në investime kapitale kemi një buxhet vjetor afër tetë milion euro dhe deri tani del janë shpenzuar vetëm rreth 30%, dhe çështja më e paarsyeshme në këtë aspekt është se ndoshta pjesa më e madhe e investimeve kapitale të paraqitura në këtë raport financiar janë projektet të cilat janë kryer vitin e kaluar, gjë që do të thotë se nuk janë për këtë periudhë për të cilën raportohet, e që këtë gjë ne e kemi thënë edhe më parë se projektet që janë kryer në periudhën e fushatës zgjedhore prezantohen si punë të kryera në këtë vit. Pra për nëntë muaj punë të Ekzekutivit të Komunës, të realizohen vetëm 30% e mjeteve buxhetore mendoj se është përqindje e vogël duke pasur parasysh edhe fazën e kushteve atmosferike ku dinamika e punimeve nuk mund të jetë si ajo që kryhet gjatë verës, pra është pak sa e zorshme të mendohet se shpenzimi i buxhetit do të jetë i suksesshëm, por megjithatë mendoj se edhe në raportin e ardhshëm vjetor këto gjëra do të paraqiten si të suksesshme dhe do të thuhet se shpenzimet vjetore kanë qenë të kënaqshme. Nuk dua të lëshohem më shumë në përmbajtjen e këtij raporti duke shpresuar që në raportet e ardhshme do të kemi lëshime të tilla më të pakta.

z. Kadri Avdiu, theksoi, edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kam thënë se ky raport është paraqitur vetëm sa për të arsyetuar mjetet e shpenzuara sepse në këtë raport ka lëshime, mirëpo në qoftë se institucionet më të larta e pranojnë këtë raport atëherë le të jetë në ndërgjegje të tyre, përndryshe ky raport nuk ka të bëjë me pagesat e bëra për vitin 2014 por në këtë raport kemi disa raste ku janë bërë pagesa për

punët e kryera në vitet 2010, 2011, 2012, 2013 dhe tani bëhen pagesa në vitin 2014, pra kjo është vërejtja kryesore që ne kemi.

Meqë është viti i parë që 14 vite që kemi raporte periodike tremujore dhe shpresoj që kjo praktikë të vazhdoj, mirëpo duhet të mësohet qeverisja komunale që të bënë prerjet buxhetore për pagesa apo të bartë mjete nga viti në vit e jo të bënë pagesa për punë të kryera 3-4 vite më parë dhe çka është më e keqja që edhe në vitin 2013 kemi pasur pagesë për të njëjtin kod që e kemi edhe tani në vitin 2014, andaj shprehi dyshimin se janë duke u bërë pagesa nga dy – tri herë apo vetëm janë duke u paraqitur në letër dhe nuk janë duke u bërë pagesa fare.

Sa i përket punimeve që janë bërë deri më tani, në bazë të këtyre pagesave del se për këtë periudhë nëntëmuajore është shpenzuar vetëm 1/3 e buxhetit, por nuk e kam atë dilemë ngase deri në fund të vitit kryhen ato punë dhe bëhen ato pagesa, mirëpo vërejtja ime është rreth realizimit projekteve, pra kompanitë hasin në pengesa tek qytetarët dhe Ekzekutivi i Komunës nuk merr masa për tejkalimin e atyre problemeve, prandaj krejt ato dënime dhe gjoba vijnë si pasoj e kësaj sepse defektet të cilat ndodhin në terren Ekzekutivi i Komunës nuk iu rrinë mbrapa, do të thotë ka telashe, pengesa dhe nuk mund të realizohen projektet sipas parametrave të përshtatshme, andaj këtu kemi vërejtje të cilën Ekzekutivi i Komunës duhet të gjen metodë për tejkalimin e atyre pengesave, vërejtje e cila duhet të merret parasysh në mënyrë që në të ardhmen mos të kemi raste të tilla. Kërkoj që në të ardhmen raportet financiare të jenë shumë më konkrete, më të sakta, më reale dhe më të specifikuar, jam në dijeni se pagesat për punë duhet të bëhen mirëpo ato mjete buxhetore të shpenzohen ashtu si duhet, pa lëshime dhe pa gabime.

z. Bahri Selimi, theksoi, duke mos dashur të ndalem në çështje të cilat u ceken nga parafolësit, dua të them një gjë e cila nuk u përmend e që figuron në tabelën e shpenzimeve sipas kodeve në këtë raport, sa i përket regjistrimit dhe sigurimit të automjeteve kam një vërejtje të cilën unë paraprakisht e kam bërë edhe në raportin financiar për vitin 2013 ku kam thënë se është një dikrepancë shumë e madhe mes këtyre dy gjërave gjë e cila figuron edhe në këtë raport e që shpresoj se do të kemi përgjigje nga drejtori i Drejtorisë përkatëse.

Regjistrimi i automjeteve, kemi 2400.00 €, ndërsa në raportin financiar për vitin e kaluar ka qenë 2305.00 €, kurse për sigurimin e automjeteve, nga 10,559.00 € që ka qenë, bie kjo shumë në 4372.00 €, prandaj kur kemi parasysh që është e pamundshme të voziten veturat zyrtare të regjistruara pa pasur sigurim, parashtroj pyetje, si ka mundësi që për regjistrim e automjeteve të ketë ngritje të kurse për sigurimin e tyre të ketë rënie kaq të madhe të shpenzimeve, prandaj këtu është një diskrepancë shumë e madhe të cilën unë nuk e kam të qartë dhe nuk jam në dijeni se a e keni edhe ju të qartë.

Gjithashtu të mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve nga një shumë prej 26,000.00 € kemi rënie në 14,057.00 €, jam në dijeni se sa më të vjetruara të jenë automjetet paraqitet nevoja për mirëmbajtje dhe riparim të tyre, do të thotë numri i automjeteve sipas regjistrimit ka rritje kurse mirëmbajtja e tyre bie, pra ne jemi duke fol gjithherë për shifra të ngritura ku janë ngritur harxhimet dhe janë ngritur investimet, kurse nuk flasim për këto rënie shumë të mëdha e që unë mendoj se keq menaxhimi më i madh është pikërisht të rëniet e mëdha në shpenzime, nga 26,000.00 € në 14,000.00 €, apo për sigurim nga 10,000.00 € në 4,000.00 €.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, duke pas parasysh se jemi duke debatuar për raportin financiar për periudhën janar – shtator 2014 e që ka të bëjë me dinamikën e shpenzimeve mund t'ju them se në DSHPMSh deri më tani buxheti është shpenzuar mbi 70%, përqindje ndoshta paksa e vogël ngase siç jeni në dijeni për rishikimin e buxhetit i cili nuk ka mund të aprovohet nga ana e Kuvendit të Kosovës e që ne kemi pasur afër 800,000.00 € të bllokuara të cilat nuk kemi mundur ti shpenzojmë deri më tani, apo edhe kemi pasur punë të kryera por që nuk kemi mundur t'i bëjmë pagesat, mirëpo me miratimin e vendimit për ri-alokimin e mjeteve buxhetore është ndryshuar brenda dhjetë ditëve tërësisht raporti i shpenzimeve në raport me punët. Prapë i qëndroj asaj që më mirë është të kemi suficit të buxhetit se sa të kemi buxhet të shpenzuar jo racional ose thënë ndryshe më mirë të kthehet në Qeverinë e Kosovës se sa të bëhen pagesa pa u kryer punët, e për këtë të jeni të bindur se nuk kemi lejuar të bëhen pagesa pa u kryer punë, pa pasur pranime teknike dhe pa pasur raporte nga terreni. Jam shumë i bindur se deri në fund të vitit, duke pasur parasysh edhe kohën që është duke mbretëruar do të kryhet edhe shumë punë dhe do të realizohet një pjesë e madhe e buxhetit sipas planifikimeve. Sa i përket asaj që e përmendi këshilltari z. Rafet Llapashtica unë them se ne gjithë herë kemi qenë që cilësia e punimeve të jetë sa më e mirë dhe asnjëherë nuk e kam thënë se jemi të kënaqur me standardin e punëve të cilat kryhen tek ne në përgjithësi dhe asnjëherë nuk lejojmë diçka për të cilën jemi në dijeni se është e gabuar, pra të gjitha punimet monitorohen dhe inspektohen nga ana e ekipeve tona, mirëpo kur flisni për ndonjë projekt të caktuar është mirë të keni informacione të plota dhe mos të merreni me segmente të vogla të ndonjë projekti ngase po humb tërësia e projekteve, dua të them, nëse projekti është 15 km dhe mund të paraqitet ndonjë problem për 10, 15 ose 100 m nuk mund të thuhet se projekti në tërësi është i dështuar, pra dua të them se përgjithësimi i së keqes nga rastet konkrete individuale të segmenteve të vogla nuk na qon në një rrugë të mirë.

Gjithashtu është ngritur çështja e investimeve të mëdha në kanalizime, unë jua rikujtoj se këto investime bëhen për shkak të kërkesave të shumta të qytetarëve për të cilat edhe ne kemi vlerësuar si shumë të arsyeshme, kurse në vitet e ardhshme me siguri se struktura e investimeve do të ndryshon, shembull ta marrim do të ndërtohen kolektorët e ujërave të zeza, pra që 15 vite nuk ka pasur mirëmbajtje cilësore të kanalizimeve nga kompanitë të cilat janë përgjegjëse, pra mund të paraqiten probleme të vogla në kyçe individuale ose familjare në rrjetin e kanalizimit e që është një distancë e vogël kurse merreni me mend problemet që mund të paraqiten në një sistem të kanalizimit mbi 300 km, mirëpo shpresoj se ato do të evitohen dhe duhet të jenë të mirëmbajtura dhe të riparueshme. Ju garantoj se për çdo defekt për të cilin kemi qenë në dijeni çdo kompani është penalizuar, dhe kjo do të vazhdon edhe në të ardhmen. Vlen të ceket se për projektet tona nuk kemi asnjë kontratë për punë shtesë pavarësisht që mund të ndodh që janë kryer më shumë punë.

Megjithatë unë prapë kërkoj nga ju që të na ndihmoni në aspektin e cilësisë së punimeve, me qëllimin më të mirë që punët të kryhen sa më mirë që të jetë e mundur.

Shpesh kam dëgjuar të thuhet se riparimet bëhen nga buxheti i Komunës, ju njoftoj se nuk qëndron ajo ngase brenda periudhës që është garancioni kompania përkatëse obligohet t'i bëjë riparimet, dhe asnjëherë nuk ka ndodhur që brenda një garancioni të bëjë komuna shpenzime shtesë për ndonjë projekt të kryer.

z. Fatmir Gashi, drejtor i Drejtorisë së Administratës, theksoi, lidhur me atë që u ngrit rreth menaxhimit të autoparkut përkatësisht për sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve,

mund të them se shumica nga ju ndoshta jeni në dijeni se autoparku i Komunës sonë deri më tani kryesisht ka qenë i varur nga donacionet e jashtme dhe kryesisht kanë qenë vetura jo të reja, me shpenzime të larta dhe që nevojitet një mirëmbajtje e tyre, vetëm dy apo tri vetura janë blerë nga buxheti i Komunës. Unë kam bërë një vlerësim të të gjitha veturave zyrtare të Komunës dhe kam kërkuar që për një numër të atyre veturave të mos zhvillohen procedurat për regjistrim fare ngase nuk ia vlen të shpenzohen mjete buxhetore për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit të tyre, pastaj komisioni përkatës ka vendos që ato vetura mos të hyjnë më në përdorim. Gjithashtu ju bëj me dije se kemi bërë kërkesë për blerjen e disa veturave të reja ku për këtë vit kemi pasur të ndara 80,000.00 €, janë zhvilluar procedurat e tenderimit dhe pritet së shpejti që të furnizohemi me 5 apo 6 vetura të reja, krejt kjo është bërë me qëllim që për vitet e ardhshme të kemi vetura funksionale në mënyrë që menaxhimi i autoparkut të bëhet më lehtë dhe me shpenzime më të vogla.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, lidhur me diskutimin e drejtorit parafolës, unë mendoj se nuk morëm përgjigje për pyetjen që iu bë nga këshilltari i Lëvizjes Vetëvendosje, ngase pyetja nuk ishte se nga kanë ardhur veturat dhe kush i ka dhuruar ato, por kishte të bëjë me menaxhimin e tyre. Nuk di se a është në dijeni drejtori i Drejtorisë së Administratës se në raportin financiar për vitin 2013 faturat kanë dal se është blerë derivate për vetura në librari, gjë për të cilën nëse nuk gaboi këshilltari z. Lutfi Rexhepi e ka dëshmuar edhe faturën të cilën e ka nxjerrë nga thesari.

z. Bahri Selimi, theksoi, fillimisht pajtoj me drejtorin parafolës ngase në bazë të asaj që edhe vetë e kam vërejtur është se automjetet janë shumë të vjetruara, megjithatë unë nuk bëra pyetje për prejardhjen e automjeteve, por pyetja ime ishte rreth menaxhimit të autoparkut përkatësisht për regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve. Drejtori e tha se është bërë ndërprerja e sigurimit dhe rexhistrimin të disa automjeteve të cilat janë vjetruara, mirëpo sipas këtij raporti demantohet ajo ngase kemi te regjistrimi i automjeteve kemi ngritje të shpenzimeve, nga 2305.00 € në 2340.00 €, prandaj si ka mundësi të ndërpritet regjistrimi i një numri të automjeteve përderisa kemi ngritje të shumës së mjeteve për regjistrimin e automjeteve, pra këtu mendoj se kemi dyshime për keqpërdorime. Pra ne nuk morëm përgjigje ngase pyetja direkte ishte diskrepanca mes regjistrimit dhe sigurimit të automjeteve.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, besoj se të gjitha sqarimet, përgjigjet dhe arsyetimet rreth këtij raporti u dhanë. Konsideroj se raporti përkatës tregon një pasqyrë reale të çdo shpenzimi që është bërë në këtë periudhë nëntëmujore të këtij viti, andaj për çfarëdo që keni të paqartë mund të kërkonit nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, 14 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua raporti financiarë i Komunës së Podujevës për periudhën janar – shtator 2014.

4. Informata mbi përgatitjet për vitin shkollor 2014/2015

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë ka pasur kërkesa nga disa këshilltarë që të ketë një informatë të tillë, drejtori i Drejtorisë së Arsimit e ka sjellë atë, ne në KPF kemi debatuar për këtë dhe jemi sqaruar aty ku kemi pasur dilema, mirëpo edhe pse në informatë janë të gjitha është rregull të debatohet, andaj unë e hapë debatin.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, vlen të përshëndetet informata e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit ngase konsideroj se është një informatë e cila pasqyron gjendjen reale të arsimit në Komunën tonë, gjendje e cila mendoj se është e mirë, mirëpo ajo që mbetet për ne të gjithë është që të mundohemi sa më shumë dhe të japim kontributin tonë për një arsim çdo herë e më të mirë.

z. Flakron Gashi, theksoi, jemi në dijeni se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komunitet kanë bukur mirë kompetenca edhe në fushën e arsimit, por kemi edhe Ligjin për Arsimin parauniversitarë e ku besojmë që jo në masë të duhur është respektuar.

Raporti i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit është më shumë ilustrativ se sa në thelb ka shpjeguar parregullsitë që janë në fushën e arsimit e që ne mund të fillojmë me fakte për secilën lëmi, dhe sinqerisht e them se unë nuk kisha dashur që sot të jem në lëkurën tuaj si drejtor i Drejtorisë së Arsimit, e që në vazhdim do të drejtohem ty si drejtor, a është e vërtetë se shërbyesve civil sipas politikave tuaja po iu kthehet pozita politike, dhe dikujt të padiplomuar në arsim i jepet e drejta për të ligjëruar në shkollë të mesme vetëm e vetëm që të keni një votë më shumë në Kuvendin e Komunës, a është në rregull i nderuari drejtor që një filozof të mban lëndën e menaxhimit të projekteve, a është në rregull dhe a kanë të drejtë që profesorët me fakultet të edukimit të mbajnë lëndë nga teknologjia informative dhe të punojnë në shkollën e mesme, a është në rregull që mësime të bëjnë me grada bachelor të mos iu shpallet vendi i punës për një apo dy vite ku ne gjithë jemi në dijeni se Ligji për Arsimin parauniversitarë, neni 2 paragrafi 1.16 thuhet se cikli i parë dhe i dytë, lidhur me kualifikimin e kërkuar për mësime të bëjnë – një program të miratuar në nivelin 5 të ISCED-it që shpie në shkollën Bachelor 180 gjer 240 kredi, pra cikli një dhe dy në nenin 13 specifikohet që ka të bëjë me shkollën fillore dhe atë të mesme të ulët, andaj këta profesorë japin mësim në shkollë të mesme ndërsa sipas ligjit kanë kualifikimin për të dhënë mësim në shkollë fillore dhe në shkollë të mesme të ulët, mirëpo ekziston edhe një bazë normative në rast të rikualifikimit, nëse këta profesorë shkojnë për rikualifikim, por në rast se në mes të kolektivit ka persona apo persona me kushte të barabarta keni të drejtë t'i mbani andaj për këtë specifikisht kërkojmë sqarime. Çështja tjetër, a është në rregull dhe a ka të drejtë një profesor i gjuhës frenge, apo që sipas jush është gjeni, të jap lëndën e gjuhës shqipe, lëndën e biologjisë, kimisë, dhe edukatës fizike, kurse jeni në dijeni shumë mirë që kemi punëtor të arsimit që ka kontribuar edhe në kohën e sistemeve të ndryshme por edhe që kanë punuar pa paga, ndërsa sot janë gjuhëtar dhe bredhin rrugëve kurse ka profesor me fakultet të gjuhës frenge që sot japin gjuhë shqipe, gjithashtu kam edhe një pyetje për të cilën ndoshta drejtori duhet të jetë shumë specifik ngase sipas të gjitha gjasave drejtori është i interesuar që të rehatoj – punësoj edhe familjarët e tij, pra i nderuar drejtor, a janë punësuar me apo pa konkurs motra juaj dhe mbesa juaj si profesoresha të gjuhës angleze, gjithashtu në shkollën teknike “Fan S. Noli” në listën e fundit të pagave të mësime të bëjnë drejtori i shkollës figuron edhe si mësime të bëjnë, mandej pse i nderuari drejtor që tri vite nuk funksionon kabineti i zdhokthetarisë në këtë shkollë kur jemi në dijeni se ai kabinet është i pajisur me makina shumë të avancuara të dhuruara donacion nga GTZ ndërsa nxënësit punën praktike e mbajnë herë në punëtori private e herë në klasë, si është e mundur i nderuar drejtor që disa profesor janë emëruar nga drejtori si koordinator dhe të kryejnë punën e kujdestarit të ditës dhe të jenë të ngarkuar me nga shtatë orë më shumë kundrejt atyre që kanë nga njëzet orë si normë të plotë, pastaj a është pranuar raporti i fundit nga inspeksioni i arsimit komunal për shkollën “Fan S. Noli” në të cilin janë gjetur shumë shkelje financiare

e që thuhet se janë shitur në një deponi të hekurishtes hekurat e bankave dhe radiatorëve të dëmtuar, dhe që nuk ka pasur një qëndrim konkret nga drejtori se kah kanë shkuar ato mjete por vetëm është thënë se janë blerë lule e dhe për lule, a ka i nderuari drejtor raport të fundit sa i përket shkollës “Xheladin Rekaliu”, nëse ndokush nuk është i njoftuar le ta kenë si informatë se atje janë vjedhur disa kompjuter ku sipas raportit të policisë nuk janë vërejtur dëme të cilat mund të bëjnë të aludosh se hyrja ka qenë me forcë, pastaj si menaxhohen mjetet e grumbulluara nga pagesat e kandidatëve të mësimit jo formal, gjithashtu në konkursin për kuadrin shkollor të shpallur sivjet sipas jush në afat, mund të jap një vërejtje se konkursi është shpallur për shkolla të caktuara pa u konsultuar këshillat e shkollave gjë të cilën e parasheh shprehimisht Ligji për Arsimin parauniversitarë në Republikën e Kosovës ndërsa në këtë raport thuhet se në kohën e publikimit të konkursit për personelin mësimdhënës për 76 vende të punës kanë aplikuar mbi 730 kandidat të cilët iu kanë nënshtruar intervistimit, andaj unë e pyes po ashtu drejtorin se a është e mundur të jenë pranuar më shumë se 76 mësimdhënës dhe si mund të na bindni ju neve se në mesin e 730 kandidatëve janë përzgjedhur ata 76 mësimdhënës si më të mirët, e them këtë ngase janë rehatuar edhe familjarë tuaj madje edhe pa konkurs fare.

Në mbledhjen e kaluar është ngritur çështja e testit të maturës, edhe ne kishim dashur që 98% të jetë arritshmëria, mirëpo unë mund të marr një shembull shumë konkret, në dy shkollat e mesme profesionale “Isa Boletini” dhe “Fan S. Noli” në afatin e qershorit 609 nxënës kanë treguar rezultat negativ, gjë e cila nuk na kënaq neve dhe që është në dëm të shoqërisë, ndërsa pse tregojnë 609 nxënës rezultat negativ vetëm në dy shkolla, konsideroj se është si pasoj që në ato shkolla kanë punuar student të padiplomuar, praktikë e cila edhe tani ata student të padiplomuar i emëroni drejtor të departamenteve apo Drejtorive përkatëse në nivel të Komunës.

Kemi edhe shumë e shumë parregullsi tjera, kemi edhe raste ku mësimdhënësit e gjuhës angleze para pensionit nxirren në rrugë ndërsa rehatohen militantët e juaj partiak. Pra të nderuar, singerisht e them se unë nuk kisha dashur që sot të jem në foltore dhe të flasë për këto të mbeta, mirëpo nëse ne mendojmë për shoqërinë tonë dhe të rinjtë tanë këtë duhet ta potencojmë. Për hir të korrektësisë për mos thyerje të privatësisë unë nuk do t'i përmendi emra të atyre profesorëve që mbajnë ato pozita, mirëpo nëse drejtori i Drejtorisë së Arsimit këtë gjë e mohon dhe nëse ka gatishmëri ne mund t'i nxjerrim edhe ata emra, mirëpo për një gjë të tillë unë nuk jam dakord të nxjerrë emra vetëm e vetëm për hir të privatësisë. Dua të them edhe një gjë, ne jemi në dijeni se në çfarë kushtesh jetojmë andaj nuk është faji i atyre mësimdhënësve sepse shpeshherë për ekzistencën e tyre familjare mund të dalin edhe jashtë arsyes njerëzore, mirëpo nuk di se si drejtori e sheh të arsyeshme që njerëz të padiplomuar sot japin mësim në shkolla të mesme, ose ose dikush i padiplomuar të ketë normë të plotë ndërsa të ketë 5-6 profesorë të lëmive dhe lëndëve të njëjta të kenë vetëm gjysmë norme.

z. Haki Rudari, theksoi, ne edhe më parë kemi kërkuar debat për këtë çështje, madje më 29.09.2014 kemi kërkuar të jetë si pikë e rendit të ditës për përgatitjet e vitit të ri shkollorë gjë e cila nuk ka ndodhur por ndodh pikërisht pas dy muaj e gjysmë të fillimit të vitit të ri shkollorë ndërsa ka mbet rreth pesë javë para përfundimit të fillimit të vitit të ri shkollorë, kështu që unë mendoj se kërkesa jonë dhe 16 votat e këshilltarëve paskan qenë plotësisht të arsyeshme që kjo pikë e rendit të ditës të hynte në atë mbledhje të shtatorit dhe mos të lihet kaq vonë, por megjithatë edhe tani ne e përkrahim dhe e përsërisim ngase është hera e parë në këtë mandat që po debatojmë për arsimin qoftë në formën e

informatës apo debatit të gjerë dhe mendoj se kjo çështje të vazhdon të debatohet edhe në të ardhmen ngase shumë shpejt do ta kemi edhe përfundimin e gjysmë vjetorit të parë e pastaj edhe përfundimin e vitit shkollorë, pra e them këtë ngase mendoj se nuk duhet të mbetemi vetëm me këtë informatë. Lëvizja Vetëvendosje qendra në Podujevë ka ndjekur me shumë vëmendje gjithë procesin e punësimit në arsimin e Komunës së Podujevës që nga shpallja e vendeve të punës deri te pranimi apo përzgjedhja e personelit arsimorë, dhe në bazë të gjetjeve të dhënat që ne i kemi marrë kemi vërejtur një numër të madh të parregullsive ku paneli intervistues është udhëhequr nga interesi dhe dirigjimi partiak ku si dëshmi është lista e të përzgjedhurve – mësimdhënësve, ne kemi kolegë këtu i cili tani ka filluar të punojnë në arsim ndërsa përgatitjen e ka pasur edhe para një viti, i gëzohem faktit që është punësuar por e shtroj si pyetje, pse është pranuar në arsim pasi që iu ka bashkëngjitur grupit të këshilltarëve e nuk është punësuar më herët ndonëse përgatitjen e kishte edhe para një viti. Konsideroj se me qëllim të arritjes së cilësisë së arsimit përzgjedhja e kandidatëve për intervistim është dashur të bëhet edhe në prani të shoqërisë civile dhe në prani të mediave, po marrë shembull Prishtinën ku 4 drejtorët e shkollave kanë qenë të obliguar të prezantojnë planin 4 vjeçar për zhvillimin e shkollës, para shoqërisë civile, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe para mediave, pse mos të ndodh e njëjta gjë edhe në Komunën tonë, por shpresoj se në të ardhmen do të ndodh. Meqë jam pjesë e punëtorëve të arsimit që 24 vite mendoj se në të kaluarën ka qenë në një aspekt ndoshta më mirë arsimit ngase së paku nuk ka qenë i politizuar, përkundër gjendjes së vështirë që kanë qenë si, përndjekja, udhëtimi, madje edhe kemi pasur raste të vrasjes së arsimtarëve, e shumë të tjerave por që politizimin nuk ka ekzistuar.

Në vazhdim unë do të përmendi disa nga parregullsitë të cilat ekzistojnë në arsimin e Komunës së Podujevës e të cilat shpresojmë se në të ardhmen do të përmirësohen:

Furnizimi me tekste shkollore, në shumë shkolla kemi furnizime me tekste në mënyrë jo të duhur, përkatësisht në shkollën ku unë punoj nxënësit e klasës së parë ende janë pa Abetare, pastaj regjistrimi i nxënësve në klasë të dhjeta ku ne si Grup i këshilltarëve i kemi vizituar tri shkollat e mesme me që rast jemi pritur mirë nga drejtorët e shkollave dhe kemi hasur në bashkëbisedim se shkollat e mesme kanë nevoja të ndryshme dhe kanë probleme. Duke specifikuar klasët e dhjeta ku ka pasur mbi 100 nxënës të paregjistruar bëjë pyetje, pse pas dy muaj e gjysmë është formuar një paralele në shkollën ekonomike kur ajo ka mund të formohet në fillim të vitit të ri shkollorë, dhe pse pas dy muaj e gjysmë është hapur një paralele në Gimnaz dhe është mbyllur një kabinet, pra edhe kjo ka mundur të ndodh në fillim të vitit të shkollor. Pastaj pranimi i kuadrit arsimor për të cilën mendoj se e kemi një çështje shumë të ndjeshme, dhe këtë duhet ta pranojmë se në Komunën e Podujevës ka mësimdhënës të cilët i japin deri në katër lëndë gjë e cila plotësisht është e vërtetë, ka pasur raste të tilla pas luftës së dytë botërore por atëherë kanë qenë kohëra, kurse të ndodh një gjë e tillë në vitin 2014 kur kemi njerëz të shumtë me fakultete dhe shkollime më të larta që bredhin rrugëve ndërsa kemi mësimdhënës të cilët i japin tri apo katër lëndë, gjithashtu sa i përket zgjedhjes së drejtorëve të shkollave ku kemi ndoshta drejtor që dy apo tri dekada me një menaxhim të dobët, mendoj se nuk është mirë të ndodh kjo ngase arsimit nuk është vetëm i një partie sikurse që nuk është vetëm i Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, por është i të gjithë qytetarëve, prandaj mendoj se është mirë që të angazhohemi të gjithë që ta zhvillojmë këtë çështje ngase është një nga shtyllat kryesore të shtetit. Sa i përket shkuarjes së nxënësve në ekskursion në Shqipëri, e kamë thënë dhe po e përsëris se deri sa mësimdhënësit duhet

të paguajnë 70-75 € nxënësit duhet të paguajnë 115 € gjë për të cilën mendoj se është një shkelje e cila nuk duhet të bëhet sepse ata janë nxënës tanë, dhe është dashur që me kohë të merren masa për t'i parandaluar këto gjëra, unë parimisht e përkrahë shkuarjen në ekskursion por duhet të ketë një menaxhim më të mirë nga ana e udhëheqësve, të dihet se ku po shkohet, kush po vizitohet, të kemi konkurrencë të çmimit e tjera, e ngrita këtë çështje ngase kam pasur shumë ankesa sa i përket kësaj çështjeje dhe besoni se në shkollën e mesme ekonomike ka shumë nxënës të cilët nuk kanë mundur të shkojnë në ekskursion si pasojë e çmimit të lartë, në KPF na është thënë se janë liruar nga pagesat shumë kategori, por kjo nuk është e vërtetë sepse në bazë të asaj sa unë kam informata kemi një rast në Gjimnaz në klasën 12/8 dy vëllezër binjakë kanë bërë kërkesë për lirim, por nuk është liruar asnjëri. Çështje tjetër të cilën më duhet ta përmend është sigurimi i shkollave në përgjithësi ngase kemi raste të ndryshme në shkolla të ndryshme e që duhet të ndërmerret diçka në këtë drejtim, gjithashtu infrastruktura nëpër shkolla nuk është në një gjendje të mirë ku mungon pastërtia, oborri, gjelbërimi, mungojnë kabinete të ndryshme e të tjera gjë që mundëson të kemi cilësi të dobët.

Pra Lëvizja Vetëvendosje do të vazhdoj të angazhohet për përmirësimin e gjendjes në arsimin e Komunës si dhe ku do që paraqitet nevoja do ta ngrisim çështjen por edhe atje ku shohim gjëra të mira do ta përkrahim dhe do të japim kontributin tonë.

z. Fatmir Rudari, theksoi, lidhur me informatën e drejtorisë së Arsimit unë dëshiroj të ndalem kryesisht rreth regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme, në informatën përkatëse thuhet se shkollat profesionale janë nga 25 nxënës në klasë, është e vërtetë që në fillim të vitit shkollor janë pranuar nga 25 nxënës mirëpo pastaj ai numër është rritur në 35 nxënës, pra fjala është për shkollën ekonomike ku në të gjitha klasët e dhjeta numërohen nga 35 nxënës me përjashtim të një paraleleje të cilën e përmendi shefi i Grupit të LVV-së, do të thotë se në çdo klasë kemi shtim të numrit në mënyrë të jashtëligjshme. Shqetësim tjetër është edhe thyerja dhe vjedhja e shkollave, çështje e cila ceket edhe në këtë informatë ku konkretisht përmendet shkolla fillore në fshatin Herticë mirëpo kemi edhe shumë shkolla tjera të cilat janë thyer dhe vjedhur ku unë do të ceku vetëm një shkolla fillore në fshatin Shtedim ku unë punoj është thyer dhe vjedhur mbi 20 herë dhe janë marrë mjete si gjeneratori, librat amzë e të gjitha mjetet tjera, dhe drejtori i shkollës është obliguar që gjithë administratën e shkollës ta mbaj në shtëpi kurse për këtë çështje nga Drejtoria e Arsimit nuk është ndërmarrë asgjë.

z. Adelinë Stublla, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës ne Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje mendojmë se nuk janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme pasi që shkolla fillore "Xheladin Rekaliu" përballet me mbushjen e oborrit të shkollës me ujëra të zeza që dalin nga kanalizimi posa të ketë të reshura atmosferike ku ne si Grup e kemi vizituar këtë shkollë dhe kemi parë fëmijët duke u ballafaquar aty afër portës me ujëra të zeza dhe kundërmim të erës, si mungesa tjera janë edhe rruga e ngushtë, mungesa e trotuareve dhe parkingu i pamjaftueshëm për personelin arsimorë dhe për prindërit të cilët i sjellin fëmijët e tyre në atë shkollë. Çështja tjetër që dua të ngris është se disa shkolla në qytetin tonë po kërkojnë nga nxënësit një shumë parash për uniforma shkollore gjë e cila për ne është shqetësuese dhe kërkojmë shpjegim nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, në formë të pyetjes për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe Ekzekutivin e Komunës në përgjithësi dua ti ngris disa gjëra apo shqetësime që kam:

-mbrëmë në media televizive pash një çështje të ngritur për shkollën e fshatit Halabak, çështje të cilën këshilltari z. Nexhat Llumnica e pati ngritur edhe më parë, e që unë si prind që jam fëmijën tim nuk kisha marrë guxim ta dërgoj në atë shkollë,

-gjatë përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave në Komunën tonë a mendon Ekzekutivi i Komunës se këta drejtor duhet të jenë menaxher të shkollave të cilët duhet të menaxhojnë çështjet e arsimit dhe personelit arsimorë, apo mendojnë t'i përzgjedhin si menaxher të qendrave të votimit, kur e them këtë mendoj se duhet të jenë tamam militant të partisë për tu emëruar drejtor i një shkolle,

-a ka ndonjë analizë Ekzekutivi i Komunës tonë se për çka është duke i përgatitur nxënësit e kësaj Komune, cilat janë fushat për të cilat Komuna jonë ka nevojë dhe që pretendon zhvillimin e saj, gjë për të cilën mendoj se është shumë absurde derisa botërisht është e ditur se Komuna e Podujevës është Komunë agrare, kurse nuk ka asnjë paralele të kësaj fushe apo lëmie,.

-komuna jonë pak a shumë deri në një masë e ka të zhvilluar hotelerinë, mirëpo nuk e besoj se ne kemi ndonjë punëtorë hotelier me kualifikim përkatës, e që është dashur të ketë, pra me këtë dua të them se është shumë e rëndësishme, mirëpo unë nuk jam në dijeni për bashkëpunimin në mes të Drejtorive të Komunës për politikën dhe planifikimet e tyre të cilat për fat të keq nuk i kanë sepse Ekzekutivi i Komunës dhe Drejtoritë e Komunës nuk kanë apo të paktën nuk kanë prezantuar para Kuvendit planifikimet e tyre as afatshkurtra, as afat mesme e as afatgjata, ne i mbështesim çështjet të cilat janë të mira siç ishte rasti i subvencionimit në bujqësi, mirëpo a kemi dhe apo përgatitim kuadro profesional prej të cilëve do të mund të materializojmë dhe të gjenerojmë më shumë të ardhura prej asaj pjese që e ndan ky Ekzekutiv.

z. Bashkim Statovci, theksoi, edhe pse emri im nuk u përmend drejtpërsëdrejti nga dikush prej parafolësve të gjithë e kuptuam se fjala ishte për mua mirëpo kjo nuk shumë rëndësi, unë më 2009-2010 kam punuar në shkollën teknike në Fushë Kosovë, më 2012-2013 në shkollën teknike të Podujevës, ndërsa nga viti 2013 kam bërë pauzë për shkak të aktivitetit tim politikë, edhe në atë kohë unë kam konkurruar mirëpo Drejtoria e Arsimit nuk ka pasur vend të mjaftueshëm për një profil të energjetikës, apo së paku drejtori i Drejtorisë së Arsimit kështu më ka thënë. Tani jam punësuar në arsim dhe është e vërtetë që unë iu kam bashkëngjitur Grupit të këshilltarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mirëpo nuk e kam bërë këtë për tu rehatuar apo punësuar, por ne kur konkurrojmë kemi një planë dhe ndoshta edhe investimet të cilat janë duke u bërë në fshatin Batllavë mund të jenë nga marrëveshje ime me LDK-në, dhe mendoj se është plotësisht e drejt sepse ne kemi obligim ndaj qytetarëve tanë në përgjithësi dhe votuesve në veçanti, prandaj nuk qëndron ajo që u tha se është pranuar në arsim dhe ka kaluar në Grupin e këshilltarëve të LDK-së vetëm sa për ta rehatuar vetën, e them këtë ngase jam i vetmi profesor në shkollën teknike që kam dy punime shkencore dhe që kam përvojën përkatëse, mirëpo kemi të bëjmë me çështje programore në formë të marrëveshjes politike me Kryetarin e Komunës. Lidhur me ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë, çështje e cila është ngritur disa herë rreth mospajtimeve për lokacionin se ku do të ndërtohet ajo shkollë, mendoj se çdo kandidat për Kryetar të Komunës hynë në garë me disa plane, dhe Kryetari aktual i Komunës ka bërë premtim që do t'ua ndërton shkollën fshatit Batllavë dhe shumica e atij

fshati i ka jap votën, ndërsa tani mbetet të shihet se a do ta zbaton atë plan dhe a do t'i mban premtimet e bërë për fshatin Batllavë.

z. Kadri Avdiu, theksoi, rreth kësaj pike konsideroj se parafolësit i thanë të gjitha, mirëpo meqë u përmend shkolla e fshatit Halabak unë mora fjalën ngase jam nga ajo pjesë, është e vërtetë se ajo shkollë është në gjendje të rëndë dhe është lajm i shpeshtë në media televizive dhe me përgjegjësi ju them se në vitet 1990-1998 ajo shkollë ka qenë 100% më e mirëmbajtur dhe në kushte më të mira për mbarëvajtjen e mësimit sesa që është tani që jemi në fund të vitit 2014, besoj se këtë gjendje e ka konstatuar edhe Drejtoria e Arsimit mirëpo nuk ka ndërmarrë asgjë. Unë mbrëmë dëgjova me vëmendje përgjigjet e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit dhe përfaqësuesit të Ministrisë që dhanë në një televizion, dhe sa unë kuptova nga ato përgjigje, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka një marrëveshje me Komunën e Podujevës që shkollën e fshatit Batllavë ta ndërtoj Ministria ndërsa shkollën e fshatit Halabak ta ndërtoj Komuna.

Lidhur me çështjen e punësimit në arsim dhe kalimit të një këshilltari në një Grup të këshilltarëve, mendoj se ne nuk duhet të lëshohemi në Kuvend për individ të caktuar, mirëpo problemet qëndrojnë tjetër kund, unë e falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që në mbledhjen e KPF-së u përgjigj realisht në pyetjet që i bëra ku një ndër pyetjet ishte se a ka mësimdhënës me shkollë të mesme, përgjigjja ishte po, pastaj pyeta a ka të punësuar jashtë konkursit, gjithashtu përgjigjja ishte po, pra këto dy gjëra më kanë interesuar dhe konsideroj se kjo gjë është e dhimbshme. U përmendën edhe vitet para luftës, mendoj se vërtetë në atë situatë që kemi qenë në ato vite, niveli i arsimit dhe punëtorëve të arsimit ka qenë shumë më i lart ndërsa për fat të keq pse sot jemi në këtë gjendje unë nuk jam në dijeni, dhe mendoj se me fëmijët tanë që nga parashkollorët e deri në përfundim të shkollës së mesme nuk duhet politizuar por atyre duhet tu jepet dije, dhe besoj se ky duhet të jetë qëllimi i të gjithëve, heqja dorë nga politizimi i arsimit.

z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, u ngritën mjaftë çështje që kanë të bëjnë me fushën e Arsimit në Komunën e Podujevës dhe unë do të mundohem të jap përgjigje në shumicën e pyetjeve dhe shqetësimeve që ju i parashtruat.

Rreth asaj që u tha se ky raport është ilustrativ, në fakt kjo është informatë dhe duhet të jetë ilustrative dhe me shifra sepse nuk di se si mund të mos jetë një informatë ilustrative dhe mos të përmbaj të dhëna statistikore. Dikush nga këshilltarët e tha se në një shkollë është një profesor me fakultet filozofik i cili është edhe menaxher i projekteve, unë ju njoftoj se ai profesor është në prag të pensionit dhe mund të ndodh që të jap një ose dy lëndë të mësimit zgjedhorë, si psikologji, filozofi etj. Nuk qëndron ajo që u tha se nuk funksionon kabineti i zdrukthëtarisë ngase ai kabinet funksionon por për fat të keq që dy vite nuk kemi fare nxënës të regjistruar në klasë të dhjeta në drejtimin e zdrukthëtarisë për shkak të mos interesimit dhe për shkak të tregut të punës, me siguri se shumica prej jush jeni në dijeni se shumica e fabrikave të cilat e kanë përdorur drurin si lëndë të parë, tani vetëm thuajse janë mbyllë. U parashtrua një pyetje e cila për mua ishte absurde dhe qesharake, por megjithatë është pyetje dhe unë do t'i përgjigjem, pyetja ishte a e ka parë drejtori i Drejtorisë së Arsimit raportin e zyrtarëve të vet të cilët i ka dërguar në një shkollë për inspektim, unë them se për çfarëdo parregullsi të mundshme për të cilat mund të kemi ndonjë informatë, por edhe në baza të rregullta, të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës vizitohen, kontrollohen, monitorohen dhe inspektohen gjithnjë në bashkëpunim të plotë me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë përkatësisht departamentin e inspektimit, dhe nuk ka shkollë që brenda një viti që të paktën nuk ka dy vizita të tilla, dhe

të gjitha dosjet e këtyre inspektimeve janë në dosjet e shkollave dhe në Ministrinë e cekur, si dhe pas çdo inspektimi janë rekomandimet dhe afatet se deri kur duhet të zbatohen gjegjësisht të implementohen ato rekomandime qofshin rekomandime të Drejtorisë së Arsimit qofshin të Ministrisë. Pastaj u përmend edhe shitja e mjeteve të amortizuara të një shkolle, është e vërtetë se janë shitur dhe atë të drejtë e kanë plotësisht shkollat ta bëjnë me miratimin e këshillit të shkollës, pastaj formohet komisioni përkatës dhe mjetet e amortizuara, siç është rasti i cekur i cili ka të bëjë me mbajtëset e bankave dhe karrigeve të cilat nuk kanë vend ku t'i vendosin ato shiten me procedura, me 3 oferta, kurse mjetet e fituara nga ky aktivitet ekonomik nuk mund të përdoren për pagesa për paga, por mund të përdoren ekskluzivisht nga ajo shkollë për çështje të ndryshme në interes të shkollës, shembull në këtë rast kanë blerë lule, pse jo, pra kryesore është që të shiten me procedurë të rregullt të shitjes dhe të bëhen pagese me procedurë të rregullt të blerjes, ngase Drejtoria e Arsimit nuk kërkon që ato mjete financiare të barten në Drejtori.

Sa i përket pagesave nga mësimi jo formal, apo siç ishte pyetja se ku destinohen ato mjete unë mund t'iu informoi disave nga ju ngase të tjerët jeni në dijeni se të gjitha pagesat për mësim jo formal bëhen përmes bankës dhe shkojnë në buxhetin e Komunës mirëpo me një Udhëzim Administrativ të Ministrisë së Arsimit shkencës dhe Teknologjisë rregullohet mënyra e shpenzimit të atyre mjeteve ku 70% e tyre destinohen për paga të mësimdhënësve të asaj shkolle të cilët mbajnë mësimin jo formal ngase ai mësim është jashtë orarit të rregullt të punës së atyre mësimdhënësve, kurse 30% e atyre mjeteve destinohen për mallra dhe shërbime të asaj shkolle, do të thotë nuk ka mundësi që mjetet e hyra nga mësimi jo formal i shkollës teknike dhe asaj ekonomike të cilat janë ato që mbajnë mësim jo formal, të destinohen apo shpenzohen për shkollën e fshatit Halabak, e mora këtë shembull ngase shkolla e fshatit Halabak po përmendet shumë shpesh.

Vlen të ceket se ndoshta jemi e vetmja Komunë në Kosovë që për arsimin jo formal i kemi liruar nga pagesa të gjithë nxënësit e familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës, ata të cilët janë në asistencë sociale, gjë e cila shkon në dëm të buxhetit tonë, sepse regjistrimi i një viti kushton 150 € plus 50 € provimet, pra totali 200 €. Rreth konkursit për mësimdhënës, u tha se drejtori i Drejtorisë së Arsimit përkatësisht unë i paskam rehatuar apo punësuar familjarët e mijë, gjë për të cilën unë e them se absolutisht është e paqëndrueshme, përkundrazi, unë kam shumë familjarë të cilët kanë të kryer fakultete të ndryshme të cilët janë pa punë dhe që unë do të doja që edhe ata të ishin të punësuar mirëpo ky është kapaciteti i Komunës tonë dhe nuk ka vende tjera të punës, shkak i kësaj është mungesa e industrisë dhe e zhvillimit ekonomik ku të gjithë njerëzit të cilët e kryejnë një fakultet kanë për synim të punësohen në arsim. Pra ne kemi pasur një konkurs, të cilin e përgatisin shkollat në bashkëpunim me këshillin e shkollës dhe e sjellin në Drejtorinë e Arsimit dhe ne e shpallim, pastaj kemi organizuar një intervistim për të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar intervistim i cili ka zgjatur rreth dy javë, dhe nga komisioni në të cilin bënë pjesë edhe drejtori i shkollës përkatëse, janë përzgjedhur ata të cilët për më së afërmi i kanë plotësuar fillimisht kushtet ligjore e pastaj edhe kushtet tjera formale siç është përvoja e punës e të tjera, ndërsa nga ajo që u tha se drejtori e ka punësuar motrën e vetë, unë ju sqaroj se motra ime është në zëvendësim të pushimit të lehonisë dhe ka kualifikimin adekuat dhe me një përvojë rreth 30 vjeçare në arsim, është e papunë por aktualisht është në zëvendësim të lehonisë edhe për tre muaj ngase do të kthehet në punë mësimdhënësja përkatëse me që rast motra ime do të

mbetet pa punë, gjithashtu u tha se gjoja unë e paskam larguar një mësimdhënës shumë vjeçar të gjuhës angleze në shkollën e teknikës dhe në vend të tij e paskam pranuar mbesën time, mendoj se duhet të jeni shumë të kujdesshëm kur të pohoni diçka veçanërisht kur të thoni, e ka larguar, sepse do të duhej të kishte një vendim për largim nga puna, askush në Komunën e Podujevës nuk është larguar nga puna deri më sot, por kemi të bëjmë me kontrata njëvjeçare ku pas përfundimit të tyre nëse kandidati i plotëson kushtet kontrata i vazhdohet, nëse nuk i plotëson kushtet atëherë vie në radhë kandidati tjetër, në rastin konkret ka ardhur në shprehje mbesa ime me fakultet adekuat të gjuhës angleze, dhe fatkeqësisht ish profesori im për të cilin kam shumë respekt dhe për të cilin unë qe pesë vite jam munduar me çdo kusht ta mbaj në punë edhe pse nuk ka arrit ta përfundoj fakultetit asnjëherë sepse nuk doja që në fund të karrierës së tij si mësimdhënës të mbetet pa punë, mirëpo unë jam i obliguar ta respektoj ligjin, pra nëse ligji e thotë se një kandidat me kualifikim superior duhet ta pranojë atëherë nuk kam çfarë të bëjë. Po ashtu dëshiroj t'ju a bëjë me dije se sa i përket pranimi të kandidatëve në arsim, në krejt këtë proces nga 731 aplikues kemi pasur vetëm tri ankesa me shkrim të cilët kanë pretenduar se u janë shkelur të drejtat e tyre, ankesa të cilat janë shqyrtuar nga inspektorati i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe që të gjitha ato ankesa kanë rezultuar si të pabaza sepse ne jemi munduar dhe do të mundohemi vazhdimisht t'i respektojmë aktet ligjore dhe ato nënligjore të cilat e rregullojnë fushën e arsimit.

Sa i përket testit të maturës, unë në një mbledhje të kaluar kur më është bërë pyetje rreth kësaj çështjeje kam treguar se ekzistojnë të gjitha të dhënat zyrtare të cilat figurojnë në këtë informatë por edhe në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, se Komuna e Podujevës ka dalë dyta me rezultat në testin e maturës në nivel të Kosovës. Në afatin e qershorit 73.22% të nxënësve të shkollave të Komunës së Podujevës të cilët ka hyrë në testin e maturës e kanë përfunduar maturën, kurse sa i përket dy shkollave profesionale, përkatësisht shkolla ekonomike me 70% në afatin e parë dhe shkolla teknike me 60.63%, vlerësime dhe rezultate për të cilat mendoj se nuk e paraqesin dhe nuk e shpërfaqin realisht cilësinë e arsimit të Kosovës, pra kjo është brengosëse sepse po të ishte ky sukses real ashtu siç është ne do të ishim më mirë se Finlanda e cila zë vendin e parë në testin e PICA-së në Evropë, kurse sa i përket testit Kombëtar të arritshmërisë nxënësit e klasëve të nënta në nivel të Komunës kanë shënuar rezultat mbi 66% ku edhe këtu mendoj se jemi lartë të renditur por shpresoj të jemi edhe me cilësi ashtu. Kam qenë një prej ithtarëve më të mëdhenj në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë që vazhdimisht kam kërkuar të hiqet testi i maturës dhe të kthehet ajo siç ka qenë më parë, provimi i diplomës.

U përmend edhe çështja rreth panelit intervistues për të cilin u tha se është panel partiak, ndërsa unë ju rikujtoj se në Kuvend është votuar ai panel dhe nëse ka qenë panel partiak atëherë pse është votuar, kurse sa i përket teksteve shkollore e kam thënë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa se shkak i kësaj është regjistrimi me vonesë i nxënësve në klasa të para ngase të gjitha të dhënat hyjnë në softuerë të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, pra nëse prindërit nuk i regjistrojnë fëmijët e tyre në klasë të parë në periudhën maj – qershor, kurse në muajin shtator vijnë prindërit dhe i sjellin fëmijët e tyre për t'i regjistruar në klasë të parë, ai fëmijë mbetet pa Abetare sepse Ministria pesë muaj përpara veç e ka numrin e nxënësve të regjistruar, ne si Drejtori e Arsimit i kemi bërë kërkesë Ministrisë për tekste shtesë por ajo nuk është miratuar, ndërsa sa i përket teksteve shkollore prej klasës së gjashtë deri në klasë të

nëntë është për keqardhje të them prej kësaj pozite ku jam që në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës ka me mija tekste nëpër depo, gjë për të cilën konsideroj se nganjëherë shoqëria jonë duke u munduar të bëjë një barazi sociale shkaktonte një pabarazi më të madhe sociale, pra e them këtë ngase nuk do të duhej që Ministria e cëkur t'i jepte tekstet falas për të gjithë nxënësit por do të duhej të kategorizonte nxënësit sipas kushteve ekonomike të tyre dhe mos të shpenzohej një shumë rreth 4 milion euro në vit nga Ministria, kurse nëpër shkolla tubohet një numër i madh i teksteve shkollore me të cilat nuk dimë se çfarë të bëjmë.

Sa i përket shtimit të dy paraleleve apo rritjes së numrit të nxënësve në Gjimnaz dhe në shkollën ekonomike, me të gjitha masat jemi munduar që shkollën e mesme teknike ta forcojmë në mënyrë që shumë mësimdhënës mos të humbin vendet e tyre të punës dhe duke u nisur prej profileve adekuate të tyre që i kërkon tregu, mirëpo të jeni të bindur se asnjë nxënës nuk është regjistruar në ato paralele shtesë pa qenë në listë të aplikacioneve që kanë qenë për dy shkollat përkatëse, por ne jemi munduar dhe kemi përdorur krejt presionin e mundshëm që një pjesë të numrit të nxënësve me sukses të mirë t'i orientojmë edhe kah drejtimet teknike, siç e keni edhe në informatë, ne kemi zvogëluar numrin e nxënësve në ato dy shkolla me qëllim që në shkollën teknike të mos mbetet shumë mësimdhënës pa punë ngase në Gjimnaz dhe në shkollën ekonomike nuk ka mbetur asnjë mësimdhënës pa punë kurse në shkollën teknike në mungesë të nxënësve kemi një numër të mësimdhënësve që kanë mbetur pa punë, por dhe që nuk ka pasur kualifikime adekuate për të punuar në ato drejtime ku kanë punuar.

Lidhur me çështjen që ka të bëjë me organizimin e ekskursionit për në Shqipëri, unë jam shumë në dakord dhe jam ithtarë i asaj që ato ekskursione të ndërpriten dhe Ministria përkatëse të gjen ndonjë formë tjetër ngase këto ekskursione më shumë janë bërë vizita turistike se sa vizita edukative arsimore, ndërsa lidhur me çmimin që duhet të paguajnë nxënësit dhe mësimdhënësit për ekskursion unë nuk mund të them asgjë ngase atë e përcakton tregu, dhe nuk është e njëjtë sikur që një grup i mësimdhënësve të organizohen dhe shkojnë në Durrës të rrinë pesë ditë me ndonjë kombibus, sikur nxënësit të cilët janë të obliguar të vizitojnë vende dhe monumente të ndryshme historike, si Vlorën, Butrintin, Krujën e të tjera. U parashtrua edhe pyetja rreth sigurisë në shkolla, çështje për të cilën pati pyetje se a janë marrë masa për këtë, unë ju informoj se gati për çdo javë thyhet nga një shkollë, para një jave është thyer shkolla e fshatit Bajqinë, pra ne nuk mund ta marrim rolin e policisë por për çdo thyerje dhe çdo hyrje me forcë apo në mënyrë të paligjshme në ndonjë objekt shkollorë menjëherë lajmërohet policia, bëhet raporti dhe policia e ka për obligim të zhvilloi hetimet, në shkollën "Xheladin Rekaliu" vitin e kaluar kanë hyrë njerëz nga jashtë të cilët e kanë lidhur rojën e shkollës dhe e kanë futur në tualetin e shkollës të cilin edhe e kanë maltretuar e pastaj i kanë vjedhur kompjuterët, pra raporti i policisë e thotë kështu dhe sipas policisë hetimet vazhdojnë, po ashtu në shkollën e fshatit Herticë kanë hyrë natën njerëz të paautorizuar në prag të sezonit që nevojitet ngrohje për shkollën, kanë prerë të gjithë gypat e nxemjes të cilët kanë qenë të bakrit në të gjitha klasët, kurse ne është dashur të intervenojmë menjëherë që ta sanojmë atë dëm i cili është edhe i kushtueshëm.

Pati diskutim edhe rreth ujërave të zeza të shkollës "Xheladin Rekaliu", ju njoftoj se në bashkëpunim me shkollën dhe prindërit e nxënësve kemi marrë masa por problemi qëndron rrjedhja e ujërave nga kanalizimet atmosferike të cilat kalojnë në lumin Llap ku posa të rritet niveli i lumit kanalizimet fillojnë të kthehen dhe të dalin në sipërfaqe,

shpresoj që ne duhet ta gjejmë një zgjidhje shumë shpejt në mënyrë që mos të na përsëritet më. Ndërsa lidhur me uniformat e nxënësve të shkollave gjë e cila u shpreh si shqetësim, ju njoftoj se Drejtoria e Arsimit nuk ka organizuar dhe nuk e ka ndërmend të organizoj blerjen në çfarëdo forme të uniformave për nxënësit e shkollave, mirëpo për këtë çështje përgjegjëse janë këshillat e shkollave të vendosin se a dëshirojnë apo jo që nxënësit e shkollave përkatëse të kenë uniformë me emblemë të asaj shkolle, pra nuk ka kurrfarë iniciative nga ana e Drejtorisë së Arsimit, por kjo gjë është në vullnetin e këshillave të shkollave.

Lidhur me shkollën e fshatit Halabak, unë vetë disa herë i kam thirr disa media televizive me qëllim të sensibilizimit sa më të madh të asaj shkolle, u tha nga një këshilltarë se ka një marrëveshje mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për atë shkollë, unë ju siguroj se nuk ka kurrfarë marrëveshje të tillë por është përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë së cekur, ndërtimi i objekteve shkollore, kurse sa i përket ndërtimit të shkollës në fshatin Batllavë, ju njoftoj se kanë filluar përgatitjet e terrenit dhe Ministria e ndërton shkollën e re në mes të fshatit ngase 12 lagje e mbështetin atë lokacion që shkolla të ndërtohet në mes të fshatit kurse vetëm një lagje është që ajo shkollë të ndërtohet në një lokacion tjetër, pra ne nuk ndërtojmë shkolla në baza të preferencave partiake por i ndërtojmë ato për fëmijët dhe nxënësit tanë.

z. Flakron Gashi, theksoi, nuk e kuptoj se si një drejtor të Drejtorisë së Arsimit të një Komune me mbi 80 mijë banorë, pyetjet e këshilltarëve të Kuvendit i duken absurde, unë atë që e thash në diskutimin tim e kam të shkruar dhe unë kam paraqitur shumë kërkesa por drejtori ka mundur t'i devijoj në shkrim, në një prej pyetjeve që bëra ishte, a e ka pranuar drejtori raportin e fundit nga inspeksioni i arsimit komunal për shkollën “Fan S. Noli”, dhe cili është qëndrimi i drejtorit për të gjeturat në atë shkollë. Drejtori e ceku një profesor për të cilin tha se ka qenë edhe profesor në kohën kur drejtori ka qenë nxënës dhe për shkak se i mungon diploma është pamundësuar vazhdimi i kontratës së punës, por unë i bëj pyetje prapë drejtorit, a nuk është ky largim nga puna kur kemi parasysh faktin se në atë shkollë ka mësimdhënës tjerë të padiplomuar, shembull, kemi rastin ku me qëllim që të sigurohet një votë më shumë në këtë Kuvend është punësuar në të njëjtën shkollë një person i pa diplomuar. Pra si ju duket juve absurde i nderuari drejtor kur unë të pyes ty, që një arsimtarë në shkollën e fshatit Shajkoc e jep lëndën e gjuhës shqipe dhe i njëjti në shkollën e fshatit Siboc e jep lëndët e biologjisë, kimisë dhe edukatës fizike, mua përgjigja e juaj më duket absurde, pra si mund të merret një pyetje e një këshilltari të Kuvendit si pyetje absurde kur kjo informatë është shumë ilustrative karshi kërkesave të këshilltarëve të Kuvendit të cilat kanë qenë pothuajse që nga fillimi i këtij mandati. Gjithashtu rreth punësimeve, mendoj se ka edhe motra të të tjerëve me përvojë 30 vjeçare në arsim dhe sot mbesin pa orë të gjuhës shqipe ndërsa një arsimtari të gjuhës frenge i jepen orët e lëndës së gjuhës shqipe. Çështja tjetër që nuk unë nuk mora përgjigje për pyetjet që unë i bëra më parë ka të bëjë me profesorë grada e të cilëve është bachelor, të cilët nëse nuk kanë shkuar për rikualifikim atyre do të duhej t’iu shpallej i lirë vendi i punës, e them këtë ngase edhe në këtë rast koicidon se është një familjare e juaja përkatësit bashkëshortja e njërit prej drejtorëve të një Drejtorie të Komunës.

Për fund kam dhe dy pyetje, cilat janë procedurat e zëvendësimit të lehonisë dhe çka e ka bërë më të favorshme motrën e juaj që të zëvendësoj një punëtore e cila ka shkuar në pushim të lehonisë, si dhe a ka Drejtoria e Arsimit ndonjë strategji që të rrisë apo shtytë dëshirën e studentëve për tu regjistruar në shkollën profesionale drejtimin e

zdrukthëtarisë, e them këtë ngase është mëkat që të ekzistojnë mjetet dhe pajisjet përkatëse kurse të mos shfrytëzohen ato kur jemi në dijeni se kemi shumë ndërmarrje të cilat merren me përpunimin e drurit në Komunën tonë.

Pas disa kërkesave të disa këshilltarëve të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit me pajtimin e shumicës së këshilltarëve vendosi që deri në ora 13:00, përkatësisht 1 orë të ketë pauzë.

Pas pauzës njëorëshe, mbledhja rifillon në orën 13:05, fillimisht u konstatua se ekziston kuorumi përkatësisht janë të pranishëm shumica e këshilltarëve të Kuvendit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje ne po e rifillojmë mbledhjen sipas rendit të miratuar të ditës, sa i përket informatës së Drejtorisë së Arsimit konsideroj se të gjitha u thanë nga parafolësit mirëpo nëse ndokush ka edhe diçka për të thënë urdhëroni fjala është për ju.

z. Haki Rudari, theksoi, ne i dëgjuam arsyetimet dhe sqarimet e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, dhe tani do të përpiqem t'i ngriti vetëm disa çështje. Lidhur me shumën e parave që paguajnë nxënësit dhe mësimdhënësit për të shkuar në ekskursion në Shqipëri drejtori e tha se mund të ketë ndonjë grup të mësimdhënësve që shkojnë me kombibus në Shqipëri, unë i them drejtorit se nuk bëhet fjalë për një grup të mësimdhënësve por bëhet fjalë për rreth njëmijë punëtorë të arsimit të Komunës së Podujevës të cilët shkojnë me autobus në Shqipëri, ndërsa sa i përket çështjes që ka të bëjë me uniformen e nxënësve kemi dy shkolla fillore të qytetit të cilat kanë grumbulluar mjete financiare për t'i blerë uniformat e nxënësve, përkatësisht shkolla e re fillore e cila ende është pa emër dhe shkolla fillore "Naim Frashëri" të cilat iu kanë kërkuar nxënësve nga 6 € deri në 8 €, shumë për të cilën mendojmë se është e papërballueshme ngase kemi familje të cilat kanë deri në katër apo pesë nxënës në shkolla. Lidhur me furnizimin me tekste shkollore drejtori i përmendi vetëm klasat e para, arsyetim që edhe unë deri në një masë pajtohem, mirëpo kemi rastin konkret ku fëmija i kolegut tim nga radhët e LVV-së është regjistruar në parashkollorë dhe sot është pa abetare, por gjithashtu kemi edhe nxënësit e klasave të teta pikërisht në shkollën ku unë punoj të cilët nuk kanë tekste shkollore, kështu që për këta nxënës regjistri ka qenë i saktë në muajin qershor. Gjithashtu kam një pyetje për drejtorin, sa arsimtarë punojnë në arsim e të cilët nuk janë me profesion adekuat, gjë për të cilën mendoj se është koha e fundit që në arsim të fillojnë të punojnë njerëz të cilët janë me profesion adekuat.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit për sqarimet dhe përgjigjet e tij rreth kësaj informate, po ashtu edhe ju falënderoj ju të gjithëve për kontributin e dhënë rreth kësaj pike të rendit të ditës, meqë kjo ishte vetëm informatë dhe nuk ka nevojë të votohet konsideroj se çdo vërejtje dhe sugjerim i juaji me siguri se do të merret parasysh.

5. Propozim Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës

- **Propozimi i vendimit për vënie në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës**

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës dhe i kemi rekomanduar Kuvendit që miratohet propozim vendimi që propozimi i rregullores përkatëse të vëhet në diskutim publik, gjithashtu është caktuar edhe data, vendi dhe koha e mbajtjes së diskutimit ku çdo vërejtje, plotësim dhe sugjerim për këtë propozim rregullore të cilat konsiderohen ligjore dhe me vend do të merren parasysh dhe do të inkorporohen në rregulloren finale, mirëpo meqë propozim rregullorja prapë do të jetë pikë e rendit të ditës për miratim në një prej mbledhjeve të Kuvendit ne do të kemi mundësi që prapë të debatojmë për këtë.

z. Burbuqe Rrahimi, theksoi, më vie mirë që më në fund kemi para vetës një rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës tonë, se çfarë është gjendja e mjedisit jetësorë në Komunën tonë dhe si është menaxhuar gjegjësisht trajtuar kjo çështje besoj që asnjëri nga ne nuk jemi të kënaqur duke u nisur nga fakti që të gjithë jemi të njohur për gjendjen e rëndë në mjedisin jetësorë dhe besoj që me këtë rregullore do të kontribuojmë për përmirësimin e gjendjes.

Dua të ilustroj me një shembull, unë personalisht banoj në rrugën “Sejdi Sekiraga” ku mbi 150 banorë e kanë të rrezikuar jetesën për shkak të hedhjes së mbeturinave në lagjen tonë. Për ata të cilët nuk janë në dijeni rruga ndodhet te “Qershiat e Llapashticës” ku përfundon me lumin Llap dhe nuk ka rrugëdalje andej lumit, vlen të ceket se në lum hedhen mbeturinat nga qyteti dhe nga disa fshatra përreth, vite me radhë kjo lagje ka qenë e pajisur me kontejner dhe banorët përveç pagesës për ata kontejner paguanin punëtorë edhe për pastrimin e lumit, ndërsa tani në lagje nuk ka kontejner dhe lumi është stërmbushur me mbeturina. Arsyeja e banorëve për mos pagesën e kontejnerëve është: ne po paguajmë mbeturinat ndërsa të tjerët vijnë e na i hedhin para shtëpisë, është kjo arsye sepse në atë lagje nuk hedhen mbeturina me një apo dy qese por hedhen me mjete të mëdha transporti dhe gjendja është e mjerueshme, ndërsa unë këtu në këtë foltore kërkoj nga organet përgjegjëse që t’i marrin parasysh këto, ngase mund të paraqitet ndonjë epidemi në atë lagje.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, dihet se menaxhimi i mbeturinave në Komunën tonë është jo i mirë, e them këtë për faktin se në rrugën kryesore të qytetit, rruga “Zahir Pajaziti”, kanë qenë të vendosur disa kontejner ndërsa tani të njëjtit janë zhvendosur në parkun e qytetit, park i cili është i ndërtuar shumë mirë, mirëpo në ata kontejner vihen mbeturina ndoshta edhe prej fshatrave të ndryshme me mjete të ndryshme transportuese gjë për të cilën mendoj se është e pamundur të përballohen gjitha ato mbeturina nga ata pak kontejner që janë në atë pjesë të qytetit dhe se si pasoj e kësaj kemi edhe ndotje të ambientit por edhe grumbullim të qenve endacak pran atyre kontejnerëve ku ne si banorë dhe si lagje e rrugës “Zahir Pajaziti”, na paraqiten rreziqe të ndryshme, andaj kërkojmë që sa më shpejt të zhvendosen ata kontejner nga parku i qytetit.

z. Haki Rudari, theksoi, pajtohem me parafolësit ngase vërtetë kemi një gjendje të rëndë sa i përket ambientit dhe higjienës në Komunën e Podujevës, veçanërisht gjendja e rëndë është në fshatra dhe në objekte të ndryshme arsimore, prandaj propozoj që të merret

parasysh që në hapësira të shkollave të vendosen kontejner, edhe pse në propozim rregulloren parashihet të bëhet ndarja e mbeturinave, po ashtu propozoj që të merret parasysh edhe përfshirja e fshatrave për arsye se mbeturina kemi edhe nëpër fshatra dhe se ajër të pastër dhe higjienë të mirë duhet të ketë edhe në fshatra.

z. Fidan Rekalii, theksoi, ne para vetës kemi dy propozime, andaj konsideroj se ne sot nuk kemi nevojë të bëjmë shumë debate ngase sot ne duhet ta miratojmë propozimin për vënie në diskutim publik të rregullores përkatëse dhe pasi të mbahet diskutimi publik ne do të kemi mundësi të debatojmë më gjerësisht edhe një herë në Kuvend para se të marrim vendim për miratimin e propozim rregullores përkatëse.

z. Haki Rudari, theksoi, habitem me faktin që një këshilltar i Kuvendit i zgjedhur me vota të qytetarëve të thotë se nuk kemi nevojë për debat, unë këtë për herë të parë e pash dhe e dëgjova këtu sot, t'ju them të vërtetën unë prita që edhe këshilltarët kolegë nga radhët e LDK-së do ta kundërshtojnë këtë që e tha parafolësi, ngase mendoj se vetë fakti që është pikë e rendit të ditës duhet të bëhet debat.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, nuk mora fjalën me qëllim që t'ua mohoj të drejtën e debatit, por me qëllim që ta kthej debatin në pikën e rendit të ditës, e them këtë ngase nuk kemi në rend dite për të debatuar për gjendjen e mbeturinave dhe gjendjen e ambientit në Komunën e Podujevës por kemi të bëjmë me propozim rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës gjegjësisht për propozim vendimin për vënie në diskutim publik të propozim rregullores së cekur me qëllim që të japin kontributin edhe qytetarët e Komunës së Podujevës që kjo rregullore të jetë sa më e mirë dhe e zbatueshme, propozim rregullore e cila është e bazuar në Ligjin për Mbeturinat, ku do të mundësohet që të ndërmerren disa hapa konkret në mënyrë që neve si Komunë të mos na paraqiten probleme në raport me kompanitë përkatëse dhe me institucionet tjera të cilat merren me fushën e menaxhimit të mbeturinave. Me siguri se e keni vërejtur në propozim rregullore ku përmendet edhe përpunimi dhe riciklimi i mbeturinave, çështje që neve na është dashur ta përfshijmë edhe këtë, mirëpo tani për tani këtë nuk mund ta bëjmë ngase nuk kemi riciklim por as ndarje të mbeturinave në Kosovë, megjithatë ne e kemi paraparë këtë në mënyrë që në të ardhmen të hyn në fuqi dhe të zbatohet edhe kjo. Gjithashtu vlen të ceket se rregullorja i qartëson të gjitha përgjegjësit e Komunës, të institucioneve tjera dhe përgjegjësitë e kompanisë për menaxhimin e mbeturinave, andaj unë besoj se me përmirësimin e kësaj rregulloreje nga ana e këshilltarëve të Kuvendit dhe nga ana e qytetarëve në ditën kur do të mbahet diskutimi publik por edhe me rastin e miratimit final të rregullores në Kuvend, neve do të na mundësohet që këtë dokument ta kemi si një udhërrëfyes për menaxhim sa më të mirë të mbeturinave në Komunën e Podujevës. Pra ju bëjë thirrje që të jeni aktiv goftë në mënyrë elektronike goftë në diskutimin publik apo në mënyrë të drejtpërdrejt apo edhe me debat të jepni propozime, mendime, vërejtje dhe sugjerime konkrete, kurse për gjendjen ambientale mund të jetë në një prej mbledhjeve të Kuvendit dhe të debatojmë mirëpo duhet pasur parasysh që në atë debat duhet të përfshihen edhe Drejtorit tjera apo edhe ndoshta institucione tjera të nivelit më të lartë.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, në lidhje me këtë propozim, kam dy këshilla për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Mekanizmi për mbikëqyrjen e kompanisë e cila merret me menaxhimin e mbeturinave duhet të jetë shumë funksional dhe mekanizëm ndëshkues në raport me atë kompani, gjithashtu kompania përkatëse medoemos duhet të siguroj qasje për hedhjen e mbeturinave në nivel të Komunës së

Podujevës, e them këtë ngase në çoftë se ne mendojmë se ajo kompani e cila e fiton tenderin dhe bënë mbledhjen e mbeturinave vetëm në qytetin e Podujevës atëherë unë konsideroj se nuk kemi bërë asgjë, pra i nderuar drejtor pajtohem me ju dhe me sugjerimet e juaja mirëpo kërkoj nga ju që të krijoni një mekanizëm mbikëqyrës dhe ndëshkues për kompaninë e cila do të bëjë menaxhimin e mbeturinave.

z. Kadri Avdiu, theksoi, propozim rregullorja është e përshkruar mirë, megjithëse drejtori parafolës e tha se nuk i kemi disa kapacitete të cilat parashihen me këtë rregullore, andaj unë mendoj se ne duhet të mendojmë t'i bëjmë ato kapacitete e mos të mendojmë vetëm të miratojmë diçka kurse në anën tjetër të mungojnë kapacitetet apo mekanizmat për implementim. Prandaj unë mendoj se ne si këshilltarë të Kuvendit duhet ta miratojmë vendimin për vënie në diskutim publik të propozim rregullores për menaxhimin e mbeturinave, mirëpo kërkoj të jemi aktiv si në diskutim publik, si në cilësinë e këshilltarëve të Kuvendit, por edhe si qytetarë në mënyrë që kjo rregullore pasi të miratohet të jetë e implementueshme në tërësi, dhe të mbikëqyret ai implementim, dhe mos të na ndodh sikurse në periudhën e kaluar që të kemi gjendje të tillë, dua të them se ne duhet të japim të gjithë kontributin tonë sepse ka të bëjë me aspektin e shëndetit dhe higjienës tonë.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u mbështet në parim propozimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës dhe u miratua propozim vendimi për vënie në diskutim publik të kësaj Rregulloreje.

6. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesave të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Podujevës dhe Ali Bekteshit nga fshati Lllashticë e Poshtme)

z. Kadri Avdiu, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës konsideroj se kërkesa e Drejtorisë së Arsimit është bërë shumë me vonesë, dhe ky është një lëshim që nuk guxon të ndodh ngase unë jam në dijeni se ka tri vite që diskutohet rreth ndërtimit të shkollës në fshatin Batllavë, dhe sa unë jam në dijeni kërkesa me masa dhe llogari është bërë në Ministrinë përkatëse për pjesën ku ka qenë shkolla tash më e shkatërruar e që më parë ka qenë pronë e Kooperativës, ndërsa përnjëherë është caktuar një lokacion tjetër. Vërejtja ime konkrete është se Ekzekutivi i Komunës ka filluar punimet për ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë dhe pastaj ka bërë kërkesë për dhënie në shfrytëzim, gjë e cila për mua është shumë e pakuptimtë, kurse sa i përket kërkesës tjetër për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore konsideroj se është çështje që ka të bëjë me pronë private dhe mendoj se duhet të mbështetet.

z. Bahri Selimi, theksoi, sa i përket destinimit të pronave bujqësore në prona ndërtimore ne në parim i përkrahim ngase mendojmë se është e padrejtë të jemi kundër atyre që kanë për synim të ngritin biznese apo lokale afariste nga të cilat mund të përfitojnë qytetarët, mirëpo çka ne jemi kundër në kërkesën e z. Ali Bekteshit është se kjo kërkesë është sjellur në Kuvend shumë me vonesë sepse në atë pronë është ndërtuar që dy vite kurse tani pas dy viteve kërkohet nga Kuvendi që të miraton një kërkesë gjë për të cilën mendoj se është shumë e padrejtë andaj besoj se në një formë të tillë nuk mund ta përkrahim një iniciativë të tillë. Sa i përket kërkesës së Drejtorisë së Arsimit për shpronësimin e tokës për ndërtim të shkollës në fshatin Batllavë, është diskutuar bukur

gjatë këtu dhe për ndërtimin e shkollave është shumë e padrejtë të votohet kundër mirëpo në rastin konkret duhet të kemi për bazë çështjen rreth konfliktit të banorëve të fshatit Batllavë për lokacionin e caktuar për ndërtimin e shkollës por edhe çështjen që me vonesë është sjellur në Kuvend, pra kemi një situatë ku ende nuk ka filluar të ndërtohet objekti por ka një kontest mes banorëve për caktimin e lokacionit, e që ne kemi thënë edhe më parë se nuk është mirë të krijojmë konflikte mes banorëve, prandaj e thash më parë se është mirë ta kemi për bazë konfliktin mes banorëve të fshatit Batllavë rreth lokacionit për ndërtimin e shkollës në atë fshat.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, faktikisht kërkesa e z. Ali Bekteshit është bërë me vonesë, konsideroj se është mirë që si procedurë të eliminohet kjo formë, dhe pasi që deri më tani është vepruar në këtë formë mendoj se nuk është mirë që ky qytetarë të penalizohet sot. Pra me këtë dua të them se në të ardhmen qytetarët duhet t'i respektojnë procedurat dhe Drejtoria përkatëse t'iu shpjegoj qytetarëve që nëse kërkesat bëhen me një procedurë të tillë ato nuk mund të procedohen më tutje, ndërsa sa i përket caktimit të lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë, besoj se parametrat e ndërtimit të një shkolle të re i dimë të gjithë sikurse që i dimë parametrat e terrenit ku do të ndërtohet shkolla e re, gjë e cila ndërlihet edhe me raportin e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit ku përmendet fillimi i punimeve të shkollës dhe sa unë jam në dijeni puna ka filluar dhe rreth 60,000.00 € janë investuar për përgatitjen e terrenit. Ne jemi në dijeni për vazhden e konflikteve mes banorëve të ndryshëm që ndodhin në terren në Komunën e Podujevës, siç është rasti lidhur me Obeliskun e Heroit Afrim Zhitia, por edhe për konfliktin mes komitetit të fshatit Batllavë rreth caktimit të lokacionit për ndërtimin e shkollës, lokacion për të cilin mua personalisht kryetari i komitetit të fshatit sot më ka dorëzuar një petition me nënshkrime dhe me numra të letërnjoftimeve të afro 300 qytetarëve nga fshati Batllavë të cilët janë kundër ndërtimit të shkollës në atë lokacion, petition të cilin e ka dorëzuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Grupit të këshilltarëve të PDK-së kurse, siç më tha ai, kam tentuar tri herë të dorëzoj në arkivin e Komunës duke përfshirë edhe drejtorin e Drejtorisë së Arsimit e që nuk është pranuar. Gjithashtu vlen të ceket edhe shkëlja ligjore që është bërë para dy viteve që ka të bëjë me bartjen e 290,000.00 € pa vendim të Kuvendit për ndërtimin e shkollës në fshatin Siboc.

Lidhur me shkollën e fshatit Batllavë e cila gjendet në lagjen Nesusht, është një prej pesë shkollave më të vjetra në Llap pas luftës së dytë botërore por edhe që sipas Frashër Demit ajo shkollë është në listacionin historik të shkollave dhe Zyrave të vendit.

Pra konsideroj se Drejtoria e Arsimit nuk e ka menaxhuar mirë këtë situatë në mënyrë që të bënë një ndërtim të ri duke përfshirë infrastrukturën përcjellëse, por ka menduar që atë ta bënë në një kryqëzim të rrugës dhe afër një objekti fetar dhe në një zonë të vërshimeve. Pra sot po legalizohet objekti që do të ndërtohet dhe po kalon në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit pa i marrë parasysh shumë faktorë tjerë si, objektet përcjellëse, kushtet për mbajtjen e orëve të edukatës fizike e të tjera. Kështu që mendoj se do të ishte mirë që Kuvendi i Komunës së bashku me Drejtorinë e Arsimit të vizitoi atë fshatë dhe të merr për bazë atë që e tha edhe parafolësi ngase jemi në dijeni të gjithë rreth kësaj çështjeje që ka pasur konflikte, kërcënime dhe arrestime në atë fshat si shkak i mospajtimeve për caktimin e lokacionit gjë për të cilën mendoj se tani veç jemi në vitin 2015 dhe duhet t'iu besojmë organeve tona. Pra unë vetëm e ndjeva si obligim që tua paraqesë petitionin e cekur dhe nëse dëshironi ua jap edhe një kopje, apo edhe

Ekzekutivi mund të kontaktoi me kryetarin e komitetit të fshatit Batllavë sepse ai është i emëruar nga subjekti politik LDK në mënyrë që të sqarohen rreth këtij peticioni.

z. Fidan Rekalu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim propozim vendimin për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, përkatësisht kërkesat e Drejtorisë së Arsimit dhe z. Ali Bekteshit.

z. Bashkim Statovci, theksoi, e ndjej obligim edhe unë të marr fjalën ngase vij nga fshati Batllavë i cili u përmend nga disa parafolës. Kryetari i komitetit të fshatit Batllavë më ka paraqitur të njëjtën çështje edhe mua ashtu sikurse z. Rafet Llapashticës, mirëpo lidhur me çështjen e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë, duke mos e përfshirë lagjen Statovci, janë shtatë lagje tjera të cilat e kërkojnë të kundërtën nga ajo që kërkon lagja Nesusht,. Pra tan mendoj se nuk është mirë të mbetet ndërtimi i shkollës peng i një lagjeje sikurse që ka ndodh më parë ku projekti për ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë është bartur në fshatin Siboc si shkak i një konflikti apo mospajtimi nga ana e një lagjeje të fshatit Batllavë. Por unë konsideroj se ne duhet të kemi parasysh se nëse në këtë vit nuk fillon ndërtimi i shkollës në fshatin Batllavë atëherë çka do të bëhet me mjetet e parapara për këtë projekt.

z. Haki Rudari, theksoi, mendoj se lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kemi dy çështje shumë të ndjeshme, njëra është për legalizimin e një objekti i cili tash më është i ndërtuar, çështje për të cilën fajtor është Ekzekutivi i Komunës i cili nuk e ka proceduar apo nuk ka marr masa më parë për atë objekt kurse tani kërkon nga Kuvendi të legalizohet objekti përkatës, kur e them këtë e kam parasysh edhe atë çfarë na është thënë rreth çështjes së Obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, kurse tani për një objekt të ndërtuar kërkohet të përkrahet.

Çështja tjetër ka të bëjë me ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë, konsideroj se duhet pasur kujdes, sepse është dashur që Ekzekutivi i Komunës të ndërmerr masa, të bisedon me banorët e lagjeve dhe ta gjen një zgjidhje. Pra ne si këshilltarë të Kuvendit e kemi të vështirë të votojmë për apo kundër, kur kemi parasysh gjendjen e rënduar në atë fshat.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, kam një propozim apo le të jetë kjo si këshill për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, në mënyrë që përgjegjësinë ta ndaj dhe mos jetë përgjegjës individual. Çështja rreth ndërtimit të shkollës në fshatin Batllavë është politizuar shumë dhe gjithashtu ka qenë arenë e debateve dhe premtimeve gjatë procesit zgjedhorë si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror nga parti të ndryshme politike, kështu që do të ishte mirë që drejtori i Drejtorisë së Arsimit t'i ftoi shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit dhe të formon një komision në mënyrë që të vizitoi dhe të kontaktoi me të gjithë banorët e fshatit Batllavë në mënyrë që të merr pëlqimin e gjithmbarshëm për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës. Ashtu siç e sqaroi z. Bashkim Statovci, unë konsideroj se paraqitet problem për ndarje të drejtësisë rreth caktimit të lokacionit për ndërtimin e shkollës në atë fshat. Njëkohësisht t'iu bëhet me dije banorëve të atij fshati se ka lokalitete me 300 banorë të cilët e kanë shkollën e ndërtuar që nga viti 1945, e them këtë me qëllim që pavarësisht që atyre banorëve iu është dhënë e drejta për ndërtimin e shkollës së re në atë fshat të bisedohet me ata banorë dhe të gjendet një mundësi që objekti i ri të ndërtohet, dhe t'iu bëhet me dije se ka shumë vende rurale në territorin e Komunës së Podujevës që ajo mundësi ende nuk iu është dhënë.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, rreth kësaj pike mendoj se jemi duke u zgjeruar më shumë se që është dashur në realitet, i vetmi shqetësim është se punët në terren kanë filluar dhe ky Kuvend nuk ka ndarë me kohë lokacione për ndërtim, ndërsa tani pasi që punët kanë filluar, po këtij Kuvendi i propozohet ndarje të lokacioneve përkatëse, çështje tjetër është se ne jemi në dijeni se nuk mund të ndërtojmë shkolla për secilën lagje apo secilën familje por nëse shtatë lagje janë për të ndërtuar shkollën në një lokacion përkatës, kurse një lagje e vetme e kundërshton atë apo është për një lokacion tjetër, atëherë nuk do të kishte kuptim të veprohej kundër vullnetit të shtatë lagjeve për interesin e një lagjeje.

Lidhur me kërkesën e z. Ali Bekteshit, ne tani veç e kemi bërë praktikë këtë, nuk jam në dijeni se a do të kishte kuptim që sot të ndryshohej ajo praktikë përkatësisht legalizimin i një objekti i cili është i ndërtuar, por konsideroj se është një lëshim që ai person nuk e ka marr lejen me kohë, mirëpo pavarësisht kësaj që e thash unë mendoj se ne sot nuk duhet të diskutojmë shumë për këto dy kërkesa por duhet t'i miratojmë.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, besoj se të gjithë jemi në dijeni për gjendjen e mjerueshme në të cilën është shkolla aktuale e fshatit Batllavë, andaj kërkoj që ta përkrahim atë lokacion përkatës ngase edhe distanca mes shkollës aktuale dhe lokacionit që është caktuar për ndërtimin e shkollës së re nuk është distancë e largët, e them këtë ngase nuk kemi nevojë të vonohemi në aspektin e lokacionit për ndërtimin e shkollës, por të bëjmë përpjekje që sa më shpejt të ndërtohet shkolla re dhe të fillohet me procesin e mësimit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk është lajmëruar më asnjë këshilltarë për diskutim, unë i hedh në votim veç e veç dy kërkesat përkatëse, atë të Drejtorisë së Arsimit dhe atë të z. Ali Bekteshit. Mirëpo para se të votojmë dua të bëjë një sqarim, lidhur me kërkesën e parë ju rikujtoj se financimin e projektit për ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë e bënë Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, kurse lejen e jep Komuna e Podujevës gjë e cila nuk mund të jepet pa u bërë destinimi i tokës, andaj ne sot nuk kemi të bëjmë me ndarje apo caktim të lokacionit. Ndërsa sa i përket kërkesës tjetër është e vërtetë se objekti është i ndërtuar por pronari është i interesuar të fillon procedurat e legalizimit të tij dhe natyrisht se kërkohet të bëhet destinimi i tokës.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, duke parë mungesën e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit unë e ndjej për obligim të jap një sqarim, dhe atë rreth objektit të cekur për të cilin u tha se nuk është dashur të lejohet ndërtimi, ne jemi dëshmitarë që në tërë territorin e Kosovës ka ndërtime të tilla, dhe me siguri se nuk do të kemi vetëm këtë kërkesë por do të kemi shumë të tjera ngase Kuvendi i Kosovës e ka votuar Ligjin për legalizimin e ndërtimeve pa leje, ku që nga fotografimi i fundit që është bërë në muajin gusht 2013 të gjitha ndërtimet të cilat figurojnë të ndërtuara pa leje do t'i nënshtrohen procesit të legalizimit të cilën e parasheh ligji i cekur dhe sipas tij të gjithë pronarët përkatës kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesa të tilla nëse nuk janë në kundërshtim me kushtet e urbanizmit.

Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, asnjë votë kundër dhe 13 vota të përmbajtura u miratua propozim vendimi për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Podujevës.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, asnjë votë kundër dhe 12 vota të përmbajtura u miratua propozim vendimi për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Ali Bekteshit nga fshati Llapashticë e Poshtme.

7. Propozimi i vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, siç jeni në dijeni nga materiali të cilin e keni marrë, është bërë një kërkesë nga KEDS që t'i jepet në shfrytëzim $4m^2$ për të vendosur një trafo në pjesën e pronës sipas propozim vendimit pronar i së cilës është Komuna e Podujevës, ku ne si Kuvend i Komunës në bazë të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës përkatësisht në bazë të dispozitave për raste të veçanta kemi të drejtë të japim pronën në shfrytëzim afatgjatë me pagesë apo pa pagesë, sipas kërkesës përkatëse, andaj duke pasur parasysh se KEDS është kompani e privatizuar, propozoj që dhënia në shfrytëzim të jetë me pagesë por me një çmim të arsyeshëm.

z. Kadri Avdiu, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi diskutuar dhe kemi ardhur në përfundim se duhet të përkrahet pasi që është gjë e definuar dhe kur kemi të bëjmë me gjëra të definuara nuk paraqitet fare problem, mirëpo neve si këshilltarë të Kuvendit shpeshherë na paraqiten gjëra të padefinuara mirë dhe të pasqaruara deri në fund, arsye që vota jonë ishte e përmbajtur për dy kërkesat për destinim të tokës bujqësore në atë ndërtimore, e them këtë sepse mendoj se pavarësisht se kush bënë gabime dhe lëshime ato duhet t'i pranoj, e pastaj të votohet, e jo të ndodh që bëhen gabime dhe lëshime të ndryshme dhe të kërkohet nga këshilltarët e Kuvendit të votohet.

Lidhur me këtë propozim vendim ne konsiderojmë se çdo vendosje e trafave në territorin e Komunës tonë është interes i qytetarëve, kompania e cila ka bërë kërkesë është kompani private dhe asaj kompanie ajo pjesë e pronës i jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, andaj duke pasur parasysh këtë dhe për ta definuar atë pronë se është pronë e Komunës, mendoj se duhet t'i vihet një tarifë, dhe propozoj që tarifa mujore të jetë 5 € në muaj për m^2 .

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe akteve nënligjore të cilat rregullojnë këtë fushë, është obligim i Kuvendit të vendos për pagesë apo mos pagesë përkatësisht të cakton çmimin e pronës së dhënë në shfrytëzim afatgjatë për raste të veçanta, rreth asaj që parafolësi e tha se KEDS është kompani private dhe prona komunale duhet t'i jepet në shfrytëzim me pagesë. Me rregulloren komunale e cila përcakton tarifat për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim ku sipas saj në zonën e qytetit tarifa është 3.50 € në muaj për m^2 , mirëpo në rastin konkret sipërfaqja është shumë e vogël, $4m^2$ si dhe duke u bazuar se KEDS është kompani profitabile unë propozoj që shuma e tarifës të jetë 2.50 € në muaj për m^2 , e që i bie 120 € në vit, shumë për të cilën mendoj se nuk është e lartë.

z. Haki Rudari, theksoi, pas një viti e gjysmë të privatizimit të KEDS me një çmim shumë të lirë, kemi ndërprerje të rrymës, çmime dhe tarifa më të larta të energjisë, dhe atë duke shtrenjtuar dy herë brenda vitit, njëherë 4.57 % dhe tani para pak muajsh 5.18 %, ku si pasojë e asaj janë organizuar edhe protesta nga qytetarët për arsye të pakënaqësive të tyre ndaj KEDS. Kështu që në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së në parim e përkrahi këtë propozim vendim, por njëkohësisht për dallim nga dy parafolësit jam për një ngritje të çmimit të tarifës komunale, dhe propozoj që shuma të jetë 10 € në muaj për m^2 .

z. Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, e përkrahim dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë KEDS-it, dhe njëkohësisht e përkrahim edhe propozimin e drejtorit Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë z. Abaz Llugaliu që shuma e tarifës mujore për KEDS të jetë 2.50 € për m².

z. Abaz Llugaliu, theksoi, lidhur me propozimin që e bëri përfaqësuesi i LVV-së konsideroj se ndoshta shuma prej 10 € në muaj për m² është shumë e lartë ngase këtu kemi të bëjmë vetëm me 4m² të pronës për dhënie në shfrytëzim KEDS-it, e them këtë ngase mund të na paraqitet ndonjë problem sepse me atë shumë KEDS mund ta tërheqë kërkesën dhe ai lokalitet mbetet pa trafo apo mund të ndodh që komuniteti i atij lokaliteti t'ia lëshon ndonjë pronë private vetëm e vetëm që mos të humb atë investim ngase vërtetë kanë probleme me tension të energjisë elektrike. Pra për këto dhe shumë arsye tjera kërkoj që ky propozim vendim të votohen njëzëri dhe shuma e propozuar për caktimin e tarifës KEDS-it, të jetë unanime.

z. Kadri Avdiu, theksoi, konsideroj se Kuvendi është ai i cili vendos, propozimin tim të mëhershëm nuk e bëra paushall por mendova që 20 € në muaj nuk është çmim i lartë, mirëpo u bënë edhe dy propozime tjera. Gjithashtu u tha nga drejtori parafolës se nëse ne i caktojmë shumë të lartë për pagesë mund të ndodh që KEDS të tërhiqet, unë konsideroj se ne nuk duhet t'ia ulim vlerën pronës komunale në raport me asnjë investitorë apo kompani.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, pajtohem me atë që e tha z. Haki Rudari rreth furnizimit me energji elektrike, mirëpo duhet të kemi parasysh se KEDS është i vetmi ofrues i shërbimeve energjetike në vend, vendosja e transformatorit, i cili sa unë jam në dijeni kushton rreth 25,000.00 €, në atë lokalitet është interes edhe i KEDS, por nëse ne ia caktojmë një shumë të pafavorshme ajo mund të tërhiqet, sa i përket tri shumave të propozuara unë pajtohem që asnjëra nuk janë shuma të larta mirëpo gjithë poenta është që ne a do të vendosim sot t'ia japim në shfrytëzim KEDS-it atë pronë apo po i largojmë investimet e KEDS, andaj do të kishte qenë mirë të vendosim njëzëri për një mesatare të tarifës e cila do të ishte e arsyeshme.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, duke pasur parasysh gjendjen e keqe të energjisë elektrike e cila është në shumë lokalitete të Llapit, konsideroj se nuk është shumë e rëndësishme tarifa që do t'i caktohet KEDS-it, por do të ishte e rëndësishme që ajo kompani të kushtëzohej me investime tjera në Komunën tonë ngase qytetarët e Komunës së Podujevës vërtetë kanë probleme me energji ku në disa vende madje është shumë e dobët sa që pamundëson kryerjen e punëve të ndryshme. Andaj konsideroj se ndoshta kishte me qenë më e arsyeshme që t'i caktohet një çmim simbolik por të kushtëzohet KEDS që të bënë edhe investime në lokalitete tjera të Llapit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, duke pasur parasysh Rregulloren për caktimin e tarifave komunale për vendosje të objekteve në pronë komunale sipas së cilës tarifa përkatëse ka qenë 3.50 € në muaj për m² në qytet, meqë prona për të cilën jemi duke debatuar është në fshat unë propozoj tarifën 2.50 € në muaj për m².

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, dhe njëkohësisht u vendos që shuma e tarifës që do të paguan KEDS-i Komunës së Podujevës, është 2.50 € në muaj për m² (dy euro e pesëdhjetë cent në muaj për metër katror).

8. Rishqyrtim, debat dhe miratim i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës hyri në rend dite me propozim të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, andaj ne sigurisht se do të debatojmë por gjithnjë duke pasur parasysh suazat e lejuara me ligj, këtë e them me qëllim që të mos të marrim ndonjë vendim të mundshëm i cili do të ishte në kundërshtim me ligjin, mirëpo si do që të jetë, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave do ti jap disa sqarime rreth kësaj pike.

z. Bahri Selimi, theksoi, falënderoj këshilltarët të cilët votuan për, që ky propozim të përfshihet në rend dite për këtë mbledhje dhe mendoj se ja vjen që kjo pikë të debatohet, mirëpo kam vërejtje të drejtpërdrejt në drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave sepse pasi unë propozova këtë pikë të futet në rend dite, i përmenduri mori fjalën dhe kërkoj që kjo pikë të mos votohet dhe u mundua të bënë presione te këshilltarët e Kuvendit, gjë e cila është antiligjore ngase nuk ka të drejtë asnjë drejtor i ndonjë Drejtorie komunale të insiston që një propozim i një këshilltari të mos futet në rend dite në mbledhje të Kuvendit, prandaj kjo është shkelje ligjore e cila u bë rreth propozimit tim.

Përveç çështjeve të cilat i ceka në diskutimin tim me rastin e propozimit të kësaj pike për të cilën konsideroj se është miratuar në mënyrë arbitrare në një mbledhje të mëparshme duke mos respektuar të drejtat e demokracisë parlamentare dhe duke shkelur mbi parimet e qeverisjes parlamentare, sistem ky i cili është aktual në Kosovë. Në këtë rast Kryesuesi i Kuvendit merr pozitën e monarkut dhe vendos në mënyrë monarkike pa e pyetur askënd për miratimin e Rregullores së cekur. Ne Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje jemi për respektimin e tërësishëm të procedurave të miratimit të Rregulloreve komunale dhe çdo dokumenti që i nënshtrohet këtij Kuvendi, dhe në bazë të kësaj, ne si Grup kemi një propozim konkret për plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015. Ligji për pronën e paluajtshme nr. 04/L-054 i miratuar në Kuvendin e Kosovës i cili rregullon statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve të Luftës, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, parasheh që kategoritë e lartcekura janë të liruar nga tatimi në pronën e paluajtshme, përkatësisht në nenin 6 ku cekën për beneficionet e veçanta të këtyre kategorive, thuhet kështu, lexon nenin përkatës, kategoritë e trajtuara në këtë ligj varësisht nga statusi dhe kriteret e përcaktuara për shkak të sakrificës sublime dhe kontributit shumë të lartë në luftën Çlirimtare të UÇK-së janë përfitues edhe të beneficioneve të veçanta siç janë: përveç beneficioneve tjera të cilat në këtë rast nuk na hynë në punë, në pikën 4 të këtij neni thuhet, lirimi nga tatimi në pronë është e drejtë që e realizojnë familjet e Dëshmorëve, familjet e të zhdukurve të UÇK-së, invalidët e UÇK-së, invalidët civil të Luftës, familjet e viktimave civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Prandaj ne si Grup konsiderojmë se Ligji nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre i miratuar në Kuvendin e Kosovës, përkatësisht neni 6 pika 4 e këtij ligji nuk është marrë si referencë në përgatitjen e Rregullores së tatimit në pronë të paluajtshme për vitin 2015, dhe me këtë rast ne konsiderojmë se është bërë shkelje e ligjit në fjalë dhe ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së kërkojmë

implementimin e këtij ligji apo përfshirjen e tij në Rregulloren e tatimit në pronë duke e shtuar një nen të veçantë i cili do të liron nga tatimi në pronë kategoritë e lartcekura.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, ne për çdo ditë përballemi me obliguesit e tatimit në pronë, dhe këtë gjë e kemi diskutuar disa herë si me Ministrinë e Financave, USAID-in, Komisionin Evropian por edhe Ministritë tjera relevante. Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministritë tjera të involvuara në këtë ligj, unë kam kërkuar sqarime se si mund të zbatohet ky ligj, por deri më sot nuk kam marr kurrfarë sqarimesh apo udhëzimesh, fundja ne jemi të obliguar që në rend të parë ta zbatojmë ligjin, e them këtë ngase këshilltari parafolës e përmendi vazhdimisht rregulloren për tatimin në pronë të paluajtshme e cila është një akt nënligjorë dhe po të mos të ekzistonte fare kjo rregullore unë do ta respektoja ligjin sepse jam i obliguar ta zbatoj ligjin, ndërsa në rregullore nuk përmenden kategori të liruar por vetëm përmenden përcaktime në vlera, kosto dhe norma të tatimit në pronë dhe kjo rregullore ekskluzivisht e ka për bazë ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, ligj të cilin unë jam i obliguar ta zbatoj, kurse sa i përket Ligjit për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, i cili është miratuar më pas, unë kam kërkuar nga niveli qendrorë që të harmonizohet me ligjin e tatimit në pronë, ngase jemi në dijeni të gjithë që në rastet kur kemi të bëjmë me hartimin e një ligji domosdo duhet të harmonizohet me ligjet tjera, rasti konkret, është dashur që me miratimin e Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, të shfuqizohej neni 8 i Ligjit për tatimin në pronë dhe të harmonizohej me nenin 6 pika 4 të Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Gjithashtu kemi kërkuar amandamentimin e ligjit për tatimin në pronë të paluajtshme apo harmonizim me Ligjin për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, që të specifikohet më ngushtë ose të futet një nen i ri në ligjin për tatimin në pronë të paluajtshme me të cilin do të liroheshin apo jo kategoritë e dala nga lufta. Është e vërtetë ajo që thuhet në ligj për ato kategori mirëpo nëse i referohemi pjesës së fundit ku thuhet, në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, dhe pikërisht për këtë kam kërkuar sqarim, se cilët persona apo cilat familje janë ato të cilat duhet t'i gëzojnë këto benefite dhe si të vërtetohet apo argumentohet kjo gjendje, sepse fatmirësisht jo të gjitha ato familje dhe gjitha ata persona që kategorizohen në këtë ligj janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale. Vlen të lexohet edhe neni 16 pika 3 dhe 4 të Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, ku thuhet se përfituesit nga ky ligj duhet të parashtrojnë një kërkesë Ministrive të linjës për gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale, dhe posa të vërtetohet ajo gjendje dhe posa të lëshohet dokumenti nga Ministria përkatëse me të cilin vërtetohet gjendja e atyre familjeve apo personave të cekur në nenin 6 pika 4 të ligjit të cekur unë sigurisht se pa kurrfarë problemi do ta zbatoj, sepse kemi të bëjmë me ligj dhe duhet zbatuar atë pavarësisht se a parashihet apo jo në rregullore, ndërsa në nenin 8 të ligjit për tatimin në pronë, precizohet qartë se cilat kategori lirohen nga tatimi në pronë të paluajtshme, e që fatkeqësisht kategoritë e cekura në Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, nuk ceken në atë

nen. Prandaj unë këtu e shoh si problem mos harmonizimin e ligjeve përkatëse andaj edhe kam kërkuar sqarime nga niveli qendrorë. Unë ju siguroj se në momentin që më vie një kërkesë e arsyeshme unë do ta zbatoj ligjin dhe do të lirohet familja apo personi të cilit iu është lëshuar dokument nga Ministria gjegjëse. Prandaj nuk e shoh të arsyeshme që për këto shkaqe të rikthehet prapë në procedurë Rregullorja e tatimit në pronë të paluajtshme, por kërkoj që të ne të mbetemi unik sa i përket kësaj çështjeje për shkak se sa jam në dijeni harmonizimi i ligjeve të cekura më lart është në procedurë dhe shumë shpejt do të rregullohet kjo çështje dhe neve do të na lehtësoj punën në aspektin e respektimit të ligjeve, por prapë po e përsërisë se nëse ndonjë familje apo person më paraqet ndonjë dokument të lëshuar nga ndonjë Ministri se lirohet nga tatimi në pronë të paluajtshme unë do ta liroj sepse ashtu thuhet në ligj, dokumente apo kërkesa që unë deri më sot nuk kam pasur asnjëherë, përveç disa personave të cilët kanë kërkuar gojarisht por me të cilët jemi konsultuar.

z. Haki Rudari, theksoi, konsideroj se kolegu nga radhët e LVV-së propozoj diçka që është e rregulluar me ligj dhe po ashtu këshilltarët votuan diçka që është e rregulluar me ligj. Jemi në dijeni se Kuvendi i Kosovës nxjerr ligje ndërsa Kuvendet e Komunave duhet t'i implementojnë dhe t'i zbatojnë ato në ndonjë rregullore, z. Bahri Selimi dhe këshilltarët e Kuvendit të Komunës së Podujevës po kërkojnë të implementohet ligji i Republikës së Kosovës nr. 04/L-054, e citoj pikën 4 të nenit 6, lirim nga tatimi në pronë është e drejtë që e realizojnë familjet e Dëshmorëve, familjet e të zhdukurve të UÇK-së, invalidët e UÇK-së, invalidët civil të luftës, familjet e viktimave civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike, pra për këto kategoritë tjera nuk kërkohet dokument apo kërkesë nga niveli qendrorë, por kërkohet vetëm për këto të fundit, kështu që unë konsideroj se është një kërkesë e Grupit të LVV-së dhe e shumicës së këshilltarëve të Kuvendit por besoj se është edhe kërkesë e pranueshme për të gjithë qytetarët, e them këtë ngase të gjithë kemi qenë pjesë e luftës, dikush drejtpërdrejt e dikush indirekt, andaj unë besoj se këtij ligji i gëzohen të gjithë, dhe ne po kërkojmë që ligjin përkatës të implementojmë përmes një rregullores përkatëse, të cilës me siguri se do t'i gëzohen të gjithë qytetarët.

z. Bahri Selimi, theksoi, lidhur me atë që e ceku parafolësi për familjet e viktimave civile të luftës të cilat janë në gjendje të rëndë ekonomike, unë konsideroj se kjo i referohet vetëm kësaj kategorie kurse të gjitha kategoritë tjera lirohen me automatizëm nga tatimi në pronë të paluajtshme. Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në diskutimin e tij e tha se po krijohen përçarje gjë për të cilën pyes, për çfarë arsye po krijohen ato përçarje, kur kemi parasysh se kjo çka ne po kërkojmë nuk është interes as i imi e as i drejtorit por është interes i atyre të cilët kanë bërë një sakrificë sublime për të cilët mendoj se i meritojnë këto benefite, andaj nuk ka nevojë të thuhet se jemi duke bërë dallime, ndarja apo përçarje, sepse është shumë jo logjike të thuhet kjo në një Kuvend me 35 këshilltarë për një çështje që është në interes të disa kategorive të cilët kanë bërë një sakrificë, kurse unë mendoj se ndarje dhe përçarje bëri drejtori i cekur në fillim të mbledhjes i cili insistoi apo bëri presion mbi këshilltarët me qëllim që kjo pikë të mos futet në rend dite.

z. Kadri Avdiu, theksoi, lidhur me kërkesën që është bërë është mirë që mos ta banalizojmë se nga cili subjekt apo cili Grup i këshilltarëve është bërë, unë nuk e kuptova drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili në diskutimin e tij e tha se ne e respektojmë ligjin por e kemi një rregullore apo akt nënligjorë dhe këto duhet të koordinohen. Konsideroj se ligji duhet lexohet në tërësi e jo me shprehje vetëm aty ku i

konvenon ndokujt, edhe pse me profesion nuk jam jurist mendoj se duhet të bëhemi real në disa çështje, drejtori i ceku disa gjëra, dhe unë jam në dijeni se kanë mbetur edhe disa çështje pa u kompletuar sa i përket ligjit në fjalë, konsideroj se drejtori ka të drejtë në aspektin kur thotë se duhet të ketë një vendim për ato kategori në mënyrë që të lirohen nga tatimi në pronë, vlen të ceket se ligji në fjalë nuk parasheh vetëm kategoritë të cilat kanë qenë aktivisht në luftë por njih edhe pjesën e viktimave civile dhe kategori tjera, dhe të gjithë ne jemi në dijeni se ato marrin edhe pensione, mirëpo problemi qëndron te mos funksionimi i Kuvendit të Kosovës ku duhet shqyrtohet dhe të hynë edhe kategoria e veteranëve të luftës pasi të bëhet verifikimi i tyre. Pra Komunitat duhet t'i implementojnë ligjet e Kuvendit të Kosovës dhe aty nuk duhet pasur dilema, mirëpo çështja konkrete mendoj se duhet të precizohet në mënyrë shumë të qartë dhe të mos jenë rregulla të njëjta sikur për një invalid të luftës i cili mund të ketë firmë milionëshe ose për të tjerët që nuk kanë firmë apo edhe janë me gjendje të rëndë ekonomike. Shumicat e Komunave në Kosovë këtë çështje e kanë rregulluar dhe i kanë liruar nga tatimi në pronë kategoritë përkatëse, kurse në Komunën tonë ka raste kur një invalid apo veteran i luftës ka paraqitur dokument por shpeshherë nuk iu është njohur ai dokument si në Komunë ashtu edhe në sportele të ndryshme të shëndetësisë dhe tjera, gjë për të cilën mendoj se është në kundërshtim me ligjin ngase ligji e njih atë kategori. Prandaj kërkesa e bërë ka të bëjë me faktin që mos të kalojnë gjërat vetëm sa për të kaluar, por vlen të ceket se nga viti 2015 gjithsesi do të fillon të zbatohet Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, kategori të cilat do të lirohen nga tatimi në pronë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para se të hedh në votim këtë propozim, do të mundohem të jap edhe një sqarim për këshilltarët e Kuvendit.

Krahas propozim projektbuxhetit të Komunës për vitin 2015 dhe projekteve prioritare për vitet 2015 - 2017 ka qenë edhe propozim Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015, propozime të cilat kanë qenë të hapura për debat në kuadër të një pike të rendit të ditës dhe të cilat kanë kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe janë miratuar në Kuvendin e Komunës, me të përfunduar debatet për këto dy pika unë e kam hedh në votim ku edhe është votuar me shumicë të votave.

Konsideroj se çështjet të cilat rregullohen me ligj duhet dhe do të zbatohen, mirëpo mos të interpretohet kjo si ndarje ndërmjet këshilltarëve apo subjekteve në lidhje me lirimin nga tatimi në pronë për kategoritë e cekura në Ligjin për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015 është përgatitur në pajtim me departamentin e tatimit në pronë pranë Ministrisë së Financave, por ne prapë do të kërkojmë sqarime nga Ministria e Financave përkatësisht nga departamenti përkatës, dhe nëse lejohet ajo çfarë po pretendohet sot në këtë Kuvend ne do ta ndryshojmë dhe do ta plotësojmë Rregulloren përkatëse.

Meqë ishte propozim unë jam i detyruar ta hedh në votim, por nuk mendoj se ka bazë ligjore.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, sa unë vërejtja nga diskutimet që u bënë lidhur me këtë pikë, konsideroj se kemi të bëjmë kolizion ligjor mes dy ligjeve përkatëse të cilat në një formë apo në formën tjetër rregullojnë çështjen që ka të bëjë me lirimin nga tatimi në pronë për kategoritë e cekura në Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, andaj propozoj që mos të hedhet fare në votim, por të kërkojmë sqarime dhe interpretim ligjor prej nivelit qendrorë përkatësisht prej Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. E bëra këtë propozim duke pasur parasysh, se kur dy a më shumë ligje, për një çështje konkrete, parashohin gjëra të ndryshme, nuk e kuptoj pse duhet të votohet sot në këtë Kuvend një çështje e tillë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, duke mos dashur që të miratojmë diçka që mund të jetë në kundërshtim me ligjin, e përkrahi dhe konsideroj se është më se e nevojshme që Kuvendi i Komunës përmes Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave me shkresë të kërkon sqarime apo interpretime ligjore nga niveli qendrorë, sqarime dhe interpretime të cilat do të na mundësojnë dhe do të na bëjnë më të lehtë marrjen e një vendimi të mundshëm në lidhje me çështjen përkatëse, andaj këtë propozim unë e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me shumicë të votave u miratua propozimi i Kryesuesit të Kuvendit.

9. Të ndryshme

Nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 14;45'

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-92702
Podujevë,
14 nëntor 2014**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**